

DI
DRITA ISLAME


TË PËRMALLUARIT PËR

Haxhin



Revista Drita Islame në versionin online...

www.dritaislame.al



TEOLOGJI

BOTA JONË

REFLEKSIONE

TRASHËGIMI KULTURORE

FAMILJA

PERSONALITETE



www.dritaislame.al

"Drita islame"
Botim i Komunitetit Mysliman
të Shqipërisë

DREJTOR
Dorian Demetja

REDAKTORË
Andrin Rasha
Mehmet Disha

DIZAJNI DHE FAQOSJA
Ejup Lila

KONTAKT:
Tel/fax 04 223 04 092
E-mail: info@dritaislame.al

Viti XXXI i botimit
Nr. 06 (469)
Qershor, 2022

ISSN 2226-7115



Artikujt

që vijnë në redaksi
dhe botohen,

nuk paraqesin domosdoshmërisht
edhe pikëpamjet e revistës.

Materialet e sjella në redaksi,
pavarësisht nëse botohen apo jo,
nuk i kthehen autorit.

PËRMBAJTJA


- 4 Vizita e Qabes së madhnueshme / Dorian Demetja
- 6 Kuptimi dhe vlerat e Haxhit / H. Bujar Spahiu
- 8 Lajme / Aktivitete



- 12 Rikthimi i Haxhit pas pandemisë / Taulant Bica
- 14 Etika: Një parim në epistemologjinë islame / Ali Xhuma
- 18 Disa pyetje dhe përgjigje rreth Haxhit dhe Kurbanit / Redaksia
- 22 Haxhi, një vështrim retrospektiv / Mehmet Disha
- 24 Amësia nuk është status, është privilegj / Nuredin Nazarko
- 26 Kurhani nga aspekti juridik / Islam Hoxha



- 28 Urtësitë e therjes së Kurbanit / Ledian Çikaleshi
- 30 "Disident" ndaj kohës / Abdullah Bulku
- 32 Xhavit Alimehmeti (1929-1997) / Xhemal Balla
- 34 Xhamia e Beqarëve, Berat / Prof. dr. Aleksander Meksi
- 36 Më fol për Krijuesin / Aisa Kokiqi
- 38 Hambari që s'u zbraz kurrë...



Vizita e Qabes së Madrnueshme

Kur viziton Qaben, shtëpinë e parë të adhurimit, e ndërtuar me urdhrin e Allahut, një pelegrin bëhet dëshmitar i faktit se cilësitë tokësore si raca, prejardhja, statusi, bukuria dhe rinia, nuk janë asgjë tjetër përveçse emërtime të përkohshme, të destinuara të humbasin. Ai përjeton në ato momente një episod nga shfaqja e madhe e ditës së ringjalljes, ditë në të cilën atij do t'i duhet të japë llogari përpara Zotit për gjithçka që ka bërë në jetë.

Zbatimi i ritualeve të haxhit është përgjigjja e duhur ndaj kërkesës, të cilën njeriu e kërkon gjatë gjithë jetës së tij. Kjo kërkesë është të fituarit e kuptimit. Njerëzit e kohës sonë po vuajnë mungesën e dhënies kuptim mendimeve dhe sjelljeve të tyre. Ndërkohë, haxhi posedon fuqinë dhe kapacitetin që t'i japë kuptim të gjitha veprave dhe mendimeve të njeriut. Shumë dijetarë janë të mendimit se udhëtimi për në haxh, është një nga mënyrat më të mira për përparimin shpirtëror të njeriut. Sipas tyre, problemet si depresioni dhe sëmundjet shpirtërore, mllëfi, smira, hipokrizia, gënjeshtria dhe shumë vese të tjera negative, pengojnë udhëtimin shpirtëror të njeriut, dhe një gjë e tillë mund të largohet gjatë ritualeve të haxhit. Prania në vendet e shenjta dhe kryerja e ritualeve fetare bashkërisht, ndihmojnë në paqtimin fizik dhe shpirtëror të njeriut.

Islami sot është i përhapur në të gjithë botën, në qindra vende të ndryshme, në etni dhe grupe racore të ndryshme. Myslimanët si asnjëherë tjetër, të bashkuar, e mirëpresin njëri-tjetrin si pjesëtarë të së njëjtës familje. Pavarësisht aderimit në disa kultura të ndryshme, ata mbeten thelbësisht të lidhur nëpërmjet të njëjtit sistem besimi e të njëjtave vlera. Dhe kjo vihet re më së miri në haxh, ku duket qartë një solidaritet mes gjithë myslimanëve. Haxhi bashkon në një qëllim të vetëm miliona myslimanë, duke u bërë shkak për krijimin e një tabloje të gjallë të barazisë dhe vëllazërisë.

Haxhi, si një nga detyrat e Islamit, që lartëson e shpalos bashkimin shoqëror mes myslimanëve, është aq madhështor e gjithëpërfshirës, sa që gjerësia dhe hapësira e tij nuk është e mundur të vërehet në asnjë vend tjetër apo bashkësi në faqe të dheut. Në një kohë kur bota në të cilën jetojmë është e mbushur me ngatërresa, përçarje dhe konflikte, haxhi duhet të konsiderohet si një rast i volitshëm për vendosjen e paqes dhe qetësisë nëpër vende të ndryshme të botës. Në haxh, largimi e përçarja shndërrohet

në unitet e bashkim dhe haxhiu e shijon tolerancën e mirëkuptimin në kulmin e saj.

Haxhi është adhurimi i fundit i obliguar për besimtarët myslimanë në vitin e 9 të hixhretit me ajetin, i cili thotë: "Vizita e shtëpisë (Qabes) për hir të Allahut është obligim për atë që ka mundësi udhëtimi te ajo"¹

Haxhi i parë në historinë islame u krye nën vëzhgimin e Ebu Bekrit, ndërsa Profeti Muhamed (a.s.) e kreu detyrën e vet të haxhit një vit më pas, në vitin e 10 të hixhretit (632). Ky qe haxhi i parë dhe i fundit i Profetit (a.s.), prandaj u quajt haxhi i lamtumirës. Haxhi përmban në vetvete vlera të shumta. Ai është rasti më ideal që myslimani të pastrohet nga gjynahet dhe gabimet e tij. Transmetohet nga Ebu Hurejra se i dërguari i Allahut (a.s.) ka thënë:

"Kush e viziton Qaben dhe nuk flet fjalë të ndyra, nuk i kapërcen kufijtë e sheriatit, kthehet nga ajo ashtu si ditën që ai lindi nga nëna"².

Haxhi është një bashkësi ritualesh të kryera në Mekë dhe e vendeve të bekuara përreth saj. Pelegrinët hyjnë në vendin e shenjtë me ihram, me qëllimin për të kryer vizitën duke zbatuar disa rregulla të caktuara. Vizita e atyre vendeve të bekuara, që ndodhen në një pjesë të nxehtë të botës, e skenave të lindjes dhe përhapjes së Islamit, duke kaluar shumë vështirësi dhe duke bërë sakrifica fizike e materiale, është argument që tregon sinqeritetin e të qenët rob i Zotit.

Gjurmë të pelegrinazhit, mund të hasen në të gjitha kulturat religjioze. Gjatë historisë, njerëzit u kanë dhënë disa vendeve të caktuara shenjtëri dhe kanë ndjerë nevojën t'i vizitojnë ato qoftë edhe një herë të vetme. Në shumicën e feve, qendrat e shenjta të vizitave bartin pothuaj të njëjtat veçori. Krahas adhurimit, pelegrinit i jepet mundësia për të parë vende të ndryshme dhe për t'u takuar me njerëz të ndryshëm.

Në të gjitha fetë, pelegrinazhi ka një sërë funksionesh. Por në asnjë fe, pelegrinazhi nuk është aq ndikues dhe veprues sa haxhi në Islam, ku njerëz nga të katër anët e botës, të pasur e të varfër, pa dallim ngjyre, gjuhe, race, kombësie, kulture dhe pozite shoqërore, vishen njëlloj, ndjekin të njëjtat rregulla duke lëvizur në të njëjtat kushte; mblidhen në të njëjtin vend e në të njëjtën kohë duke krijuar një unitet ndjenjash. Në këtë drejtim, jemi të bindur se kuptimin më të plotë e të përsosur në të gjitha aspektet, haxhi e ka gjetur në fenë islame.

KUPTIMI DHE VLERAT E

Haxhit

Rituali i haxhit, në formën e tij të njohur, është një adhurim që zë fill nga koha e Ibrahimit (a.s.). Kur'ani fisnik, në ajetet 26-28 të sures Haxh, bën fjalë për haxhin e Ibrahimit, për thirrjen e tij drejtuar njerëzve për të marrë pjesë në haxh, për historinë e Qabes e të riteve të haxhit. Haxhi është vizita që kryhet në Qabe dhe në vendet e bekuara përreth saj, me qëllim përmbushjen e një adhurimi fetar në intervalin e caktuar kohor. Në Kur'an është urdhëruar e thënë: "Kryeni Haxhin dhe Umren për hir të Allahut." (Bekare, 196). Riteve që kryhen në haxh, me një shprehje të përgjithshme, u thuhet "menasik", ndërsa ai që e zbaton këtë ritual quhet "haxhi".

Profeti ynë, paqja qoftë mbi të, në një hadith ka urdhëruar: "Pa dyshim, Allahu jua ka bërë detyrim haxhin, ndaj kryejeni atë." (Muslim, Haxh 412; Nesai, Menasik, 1). Ndërsa një tjetër hadith është formuluar kështu: "Islami ngrihet mbi pesë shtylla. Këto janë: të dëshmosh se nuk ka tjetër Zot përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Allahut, të falësh namazin, të mbash agjërimin, të japësh zekatin dhe të kryesh haxhin." Kështu, Profeti e ka cilësuar haxhin si një ndër pesë kushtet themelore të Islamit dhe ka treguar personalisht në mënyrë praktike se si duhet bërë ai.

Kur Profeti ynë, paqja qoftë mbi të, u bëri të ditur shokëve të tij obligimin e haxhit, njëri prej tyre pyeti: "Çdo vit?" Profeti heshti. Kur kjo pyetje u përsërit tri herë, ai u përgjigj: "Nëse do të thosha po, haxhi do t'ju bëhej i detyruar për çdo vit dhe ju për këtë nuk do të kishit mundësi." (Muslim, Haxh, 412; Nesai, Menasik, 1). Çdo mysliman, mashkull apo femër, që plotëson kushtet përkatëse, pra që ka mundësitë shëndetësore dhe financiare për të kryer haxhin, të paktën një herë në jetën e tij duhet ta çojë në vend këtë detyrim. Rituali i haxhit, sapo të krijohen mundësitë, duhet të përmbushet pa vonesë. Çdo mysliman që e ka kryer haxhin një herë në jetën e tij, llogaritet ta ketë kryer këtë detyrim. Kryerja e haxhit pa u vonuar, krahas ajeteve përkatëse që shërbejnë si argument, theksohet edhe prej hadithit vijues:

"Nxitoni të shkoni në haxh, sepse askush prej jush nuk mund ta dijë se kur do t'i vijë vdekja." (Ebu Davud, Menasik, 5; Ibn Maxhe, Menasik, 1).

Haxhi ka plot dobi vetjake dhe shoqërore. Më kryesoret janë këto: haxhi mundëson që individit t'i falen mëkatet dhe zemra e tij të pastrohet prej gjynaheve. Profeti i nderuar, paqja qoftë mbi të, në një hadith të tij thotë: "Kushdo që për hir të Allahut kryen haxhin dhe u shmanget fjalëve dhe sjelljeve të pahijshme e nuk përlyhet prej mëkatesh, kthehet i pastruar prej mëkateve sikur sapo të ketë lindur nga nëna." (Buhari; Haxh, 4). Në të tjera thënie të tij qëndron: "Shpërblimi i haxhit të pranuar nuk është asgjë tjetër veç parajsës", "Edhe në umre pastrohen mëkatet e kryera në kohën që ndan njëren umre nga tjetra." (Muslim, Haxh, 437; Nesai, Menasik, 3-5).

Pyetjes "Cila nga veprat është më e rëndësishmeja?", Profeti ynë i është përgjigjur: "Besimi tek Allahu dhe tek i Dërguari i Tij". I pyetur: "Po më pas?", është përgjigjur: "Xhihadi në rrugën e Allahut". I pyetur sërish: "Po më pas?", ka urdhëruar e ka thënë: "Haxhi i pranuar." (Buhari, Haxh, 4; Nesai, Menasik, 4).

Vlerat e besimtarëve që kryejnë haxhin, në vështtrimin e Allahut janë shumë të larta. Profeti ynë i nderuar e ka shprehur këtë të vërtetë duke pohuar: "Ata që kryejnë haxhin dhe umren janë mysafirët e Allahut. Nëse i drejtohen

Allahut me lutje, Ai ua pranon. Në iu drejtoftshin me pendesë, Ai i fal." (Ibni Maxhe, Menasik, 5). Në një tjetër hadith, që thotë: "Kryejini njëren pas tjetrës haxhin dhe umren, sepse haxhi dhe umra i asgjësojnë varfërinë (për shkak të tregtisë që mund të bëhet) dhe gjynahet siç pastron kaceku hekurin, arin dhe argjendin prej ndryshkut" (Tirmidhi; Haxh, 2; Nesai, Menasik, 6); na jepet sihariqi se haxhi, krahas pastrimit prej mëkateve, bëhet shkak që njeriu të shpëtojë edhe prej varfërisë.

Haxhi dhe Umra bëhen shkak që faltorja e bekuar e Qabes çdo vit të mbushet me shend e gjallëri. Haxhi e pastron egon e njeriut prej mëkateve, e bën atë të dëlirë, e pajis me kthjelltësi besimi, i çel dyert e një jete të re, përforcon jetën shpirtërore, konsolidon besimin që ai ndien kundrejt mëshirës dhe faljes hyjnore. Haxhi forcon e rrit besimin, ndihmon në ripërtëritjen e besës së dhënë Allahut, çon drejt asaj pendese të fuqishme që nuk shkelet lehtë, e pastron krejt shpirtin duke rafinuar ndjenjat dhe thuajse i jep krahë atij.

Haxhi i kujton njeriut të kaluarën e shkëlqyer të Islamit. Ai i sjell ndërmend besimtarit Profetin tonë, paqja qoftë mbi të, që me moralin dhe me veprat e tij ndriçoi botën, si dhe sakrificat dhe heroizmat e sahabëve të tij të zgjedhur dhe të njerëzve të ruajtur që i pasuan ata në mënyrën më të bukur.

Për më tepër, haxhi e mëson njeriun me durim, me vetëdisiplinë dhe bëhet shkak që ai të fitojë ndërgjegjen e bindjes ndaj urdhërësive hyjnore. Përmes ritualit të haxhit, njeriu e falënderon më mirë Zotin e vet, gjen rrugën e të qenit më thellësisht mirënjohës për mirësitë e pasurisë, të shëndetit e të mirëqenies që Zoti i ka dhuruar.

Për sa u përket vlerave shoqërore, haxhi, pa marrë parasysh ndarje në baza ngjyre, gjuhe, race, kombësie, kulture, pozite shoqërore e posti politik, bashkon me një qëllim të vetëm miliona myslimanë duke u bërë shkak për krijimin e një tabloje fort të gjallë të barazisë e të vëllazërisë. Të gjithë haxhinjtë, të pasur e të varfër, të fuqishëm e të dobët, të veshur njëlloj, duke ndjekur të njëjtat rregulla, duke iu nënshtruar të njëjtave vështirësi, duke lëvizur në të njëjtat kushte, kalojnë nëpër një edukim të barazisë fizike e të vëllazërisë. Teksa një besimtar i pasur që ka në zotërim pasuri të mëdha, sikurse dhe një besimtar më i varfër e që përjeton shumë vështirësi ekonomike, çelin së bashku duart për t'u lutur në Arafat dhe ecin pranë e pranë në tavaf rrotull Qabes. Rituali i haxhit u mëson njerëzve që të mos mburren me pozitën shoqërore e politike, me begatinë e me pasurinë, por të njihen e të shoqërohen me myslimanë të tjerë.

Rituali i haxhit lë te myslimanët kujtime të thella që nuk fshihen dot gjatë gjithë jetës. Në saje të haxhit, mes myslimanëve që vijnë e bashkohen nga vende të ndryshme të botës lindin njohje e ndërveprime të bukura. Myslimani që kryen haxhin zhvillon cilësi të bukura si durimi, kapërcimi i vështirësive, të mbështeturit dhe të ndihmuarit e ndërsjellë dhe përshtatja me rregulla të caktuara.

Haxhi i mbart vizitorët në kohë katërmëdhjetë shekuj më parë. Ai u kujton atyre ato beteja të mëdha që janë zhvilluar në ato vende në emër të besimit. Haxhi e bën njeriun të përjetojë një panoramë që i përket parajsës dhe i shfaq të vërtetën se në këtë botë ai s'është veçse një vizitor i përkohshëm.



1

VIZITË NË SHTETIN E VATIKANIT

Me ftesë të Papa Françeskut, Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, vizitoi shtetin e Vatikanit, nga ku u prit në një audiencë të veçantë nga Papa.

Takimi kokë më kokë midis Papa Françeskut dhe Kryetarit Spahiu zgjati për më shumë se 30 minuta.

Bashkëjetesa paqësore ndërmjet feve në Shqipëri, Dokumenti i Vëllazërisë Njerëzore i nënshkruar midis Imamit të Madh të Al-Az'har, Ahmed Tajib dhe Papa Françeskut, ishin temë kryesore e bisedës që z. Spahiu zhvilloi gjatë audiencës me Papën.

Dy krerët e lartë ndanë mendime të njëjta për rolin që luan feja në marrëdhëniet ndërnjerëzore, kontributin që ajo luan për ruajtjen e këtyre vlerave, sidomos në mbrojtjen e familjes, si qelizë themelore e shoqërisë, rol të cilin ata e vlerësuan si të pa çmueshëm.





Papa vlerësoi rolin e veçantë të Kryetarit Spahiu në promovimin dhe përhapjen kudo në Shqipëri të Dokumentit të firmosur në Abu Dabi mbi vëllazërimin njerëzor.

Kryetari Spahiu gjatë audiencës i kërkoi Papa Françeskut mbështetjen e shtetit të Vatikanit për pavarësinë e Kosovës.

Të dy krerët shkëmbyen edhe dhuratat e rastit në fund të takimit.

Takimi midis Papës dhe Kryetarit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë është i pari në llojin e tij që prej themelimit të KMSH-së.

Më pas, takimet e kryetarit Spahiu vijuan me Sekretarin e Vatikanit për Marrëdhëniet me Shtetet (Ministri i Jashtëm), imzot Paul Richard Gallagher dhe me Kryetarin e Këshillit Papnor për Dialogun Ndërfetar, kardinalin Miguel Ángel Ayuso Guixot.

Kryetari Spahiu, së bashku me delegacionin që e shoqëronte, u prit dhe shoqërua gjatë gjithë kohës nga e ngarkuara me punë e Republikës së Shqipërisë në Vatikan, znj. Majlinda Dodaj.





2

KRYETARI SPAHIU MERR PJESË NË KONFERENCËN "UNITETI ISLAM – KONCEPTI, MUNDËSITË DHE SFIDAT"

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, mori pjesë në konferencën ndërkombëtare me temë "Uniteti Islam - Koncepti, Mundësitë dhe Sfidat", e cila organizohet nga Këshilli Botëror i Komuniteteve Myslimane, nën kujdesin e Ministrisë Emiratase për Tolerancën dhe Bashkëjetesën, në Abu Dabi, në datat 8-9 maj, me ftesë të posaçme nga Ali Rashid al-Nuajmi, kryetar i KBKM.

Gjatë konferencës në fjalë, kryetari Spahiu përfaqësoi Komunitetin Mysliman të Shqipërisë, duke zhvilluar takime me kryetarë komunitetesh myslimane dhe ministra të çështjeve fetare nga shumë vende të botës.

Gjatë këtij aktiviteti, z. Spahiu shoqërohej nga kancelari i KMSH, z. Ylli Cikalleshi, drejtori i Vakf-Investimeve, z. Edison Hoti, drejtori i Marrëdhënieve me Jashtë, z. Fejzi Shaholli, këshilltari i tij për marrëdhëniet me vendet arabe, z. Jamal al-Safarti dhe myftiu i Gramshit, z. Ermir Gjana.

3

ÇASTE NGA DHURIMI I GJAKUT NË XHAMINË "ET'HEM BEU"

Tashmë është bërë traditë nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë që periudha kohore Maj-Qershor t'i kushtohet organizimit fushatës së dhurimit të gjakut në mbështetje të talasemikëve. Kjo fushatë në vazhdim do të shtrihet edhe në xhami të tjera të kryeqytetit.

Fëmijët talasemikë janë një kategori që në përditshmërinë e tyre vuajnë nevojën për gjak. Në Shqipëri janë rreth 155 fëmijë që marrin trajtim të vazhdueshëm për të pasur një gjendje shëndetësore sa më optimale.

Allahu (xh.sh) na bëftë prej atyre që kontribuojnë në këtë kauzë jetike!





4

VIJON CIKLI I BISEDAVE "FRYTET E BESIMIT"

Takimi "Frytet e Besimit" kësaj here u zhvillua në Xhaminë e Botanikut, me datë 26.05.2022.

Për të ligjruar për besimtarët e mbledhur me këtë rast ishin: Nënkrjetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Taulant Bica, i cili referoi mbi lidhjen e besimtarit me Allahun (xh.sh) dhe Profetin Muhamed (a.s), imami i xhamisë Et'hem Beu, Elton Karaj, me temën: "Veçoritë e besimtarit që përmenden në suren Ra'd", dhe imami Abdullah Ziba, i cili lexoi për të pranishmit disa vargje nga Kurani Famëlartë.

Të lartëpërmendurit u pritën nga imami i xhamisë "Botaniku", Aorel Senja dhe xhemati i kësaj zone.

Në fund të programit të pranishmit u bënë pjesë e koktejlit të organizuar me këtë rast.



RIKTHIMI I HAXHIT PAS PANDEMISË

Falenderojmë Allahun që pas dy viteve privim të detyruar, këtë vit na mundësoi kryerjen e obligimit të Haxhit. Dëshirojmë të ndajmë me ju disa ndjesi dhe informacione rreth këtij obligimi të rëndësishëm për çdo besimtar.

Abdullah bin Mubarak (736-796) pasi kthehet nga Haxhi shikon në ëndërr disa engjëj që zbresin në tokë dhe dëgjon njërin engjëll që pyet tjetrin se sa veta shkuan këtë vit në Haxh. Engjëlli i thotë 600 mijë. Tjetri e pyet përsëri se sa vetëve ju pranua? Engjëlli i thotë që normalisht nuk ju pranua asnjërit. Por u pranua Haxhi i këpucarit nga Shami i quajtur Ali bin Muvafak dhe më pas për hatër të atij Allahu pranoi dhe Haxhin e të tjerëve.

Më pas Abdullahu zgjohet. U habit shumë sepse gjithë ajo sakrifice dhe gjithë ata njerëz që kishin shkuar në Haxh dhe si përfundim nuk ishte pranuar prej tyre vetëm se për hatër të dikujt tjetër që në fakt nuk kishte shkuar fare në Haxh.

Menjëherë nisat drejt Shamit dhe me të pyetur e gjen dhe del përpara Ali bin Muvafakut.

I thotë më trego se çfarë vepre ke bërë tani afër që Allahu të ka pranuar Haxhin dhe për hatërin tënd ja pranoi dhe 600 mijë personave përfshijë dhe mua.

Ali bin Muvafaku thotë: "Unë jam këpucar dhe kam 30 vjet që kam bërë njet për të shkuar në Haxh dhe po mbledh para. Këtë vit e sigurova shumë e duhur, m'u plotësuan edhe kushtet e tjera dhe kisha vendosur të shkoj në Haxh. Gruan e kisha shtatzënë dhe një ditë më kërkoi pak ushqim nga komshiu sepse i kishte pëlqyer aroma e gatimit. Trokita tek komshiu dhe i kërkova nga ushqimi që kishin gatuar. Zonja e shtëpisë me tha që ushqimi nuk është hallall për ju sepse po e gatuj me mishin e një kafshe të ngordhur që e gjeta në rrugë pasi femijët kanë 3 ditë pa ngrënë nga pamundësia. Në atë moment thash me vete që Haxhi im është këtu dhe ja dhurova të gjithë shumë që kisha mbledhur sepse nuk mund t'i lija ata fëmijë në atë gjëndje."

Pas kësaj Abdullah bin Mubaraku thotë që Allahu më paska treguar një ëndërr të vërtetë.

Lexues të nderuar, Haxhi është një ndër 5 adhurimet kryesore në fenë Islame i cili ndikon shumë në marrëdhënien e njeriut me Krijuesin e tij.

Përveçse adhurim, në aspektin shoqëror konsiderohet si një tubim që manifeston harmoninë dhe barazinë e njerëzve përpara Allahut xh.sh. Nëpërmjet tij, miliona besimtarë nga të katër anët e botës, pa marrë parasysh dallimet e gjuhës, ngjyrës, kombësisë, racës, pozitës shoqërore etj., bashkohen në të njëjtin vend dhe formojnë një tablo të mrekullueshme të barazisë vëllazërore dhe të qenit krijesë e dorëzuar përpara Krijuesit.

Por në Kur'anin Famëlartë dhe Hadithet e Profetit Muhamed a.s shikojmë qartë për kushtin se "singeriteti" është elementi shpirtëror bazë që një akt adhurimi ose vepër, që të pranohet e rregullt tek Allahu i Madhëruar.

Allahu thotë në Kur'anin Famëlartë: "E megjithatë, ata qenë urdhëruar vetëm që të adhuronin Allahun me përkushtim të singertë, duke qenë në fenë e pastër (të Ibrahimit), si dhe të falnin namazin e të jepnin zekatin. Kjo është feja e drejtë." (Kur'an 98:5)

Ndërsa Profeti Muhamed a.s shprehet qartë në hadithin e cilësuar si "hadithi i njetit" se: "S'ka dyshim se ç'do punë ka qëllimin (motivin) e saj se përse kryhet, po ashtu s'ka dyshim se ç'do punë, vepër, adhurim që bën njeriu do të shpërblehet vetëm për atë ç'ka ka patur për qëllim, njet..." (Buhariu 1)

Së fundmi, nuk duhet të harrojmë se ky adhurim kategorizohet si adhurim fizik dhe shpirtëror. Realizimi i të cilit nuk mjaftohet vetëm me dëshirën e personit por njëkohësisht është i domosdoshëm shëndeti dhe ana financiare e individit.

E para, besojmë se nuk i mungon asnjë besimtari por, qoftë edhe nga dëshira e mirë, të mos e humbasim durimin dhe etikën ndaj njerit-tjetrit apo ndaj institucioneve brenda dhe jasht vendit se pse nuk na plotësohet dhe konvenon pjesa e dytë, kryesisht ajo financiare. Por ti drejtohem Allahut me lutjet dhe ndjenjat më të singerta që një ditë të na e mundësoi kryerjen e këtij adhurimi. Sepse Allahu kurrë nuk do t'i kërkojë llogari askujt për atë ç'ka nuk e ka në dorë por e sigurt që do të kërkojë llogari për mënyrën e komunikimit me njëri-tjetrin.

Allahu ia mundësoftë kryerjen e Haxhit çdo zemre të singertë që me të vërtetë e ndien në thellësinë e shpirtit dëshirën për zbatimin e urdhërit hyjnor dhe mallin për Qaben e Bekuar.



Etika **NJË PARIM NË EPISTEMOLOGJINË ISLAME**

Islami është caktuar për objektiva më të larta të krijuara për të përmirësuar sjelljen e atyre që përpiqen të ndjekin udhëzimet e tij. Shpresa është që të sjellë përfitime si për shoqërinë ashtu edhe për individët. Këto objektiva të nderuara synojnë të ofrojnë siguri dhe paqe duke garantuar sigurinë e jetës së dikujt, lirinë për të praktikuar besimin, të drejtën për të fituar pronë dhe për të pasur familje, si dhe duke ruajtur intelektin.

Zoti na ka urdhëruar të veprojmë me mëshirë dhe na ka ngarkuar me përgjegjësinë për t'u njohur me njëritjetrin dhe për të jetuar së bashku në paqe, në mënyrë që feja të praktikohet vetëm për Zotin dhe asnjë njeriu të mos i jepet autoritet mbi një tjetër. Qëllimi i kësaj recete është të sigurojë që të gjithë të jenë të lirë të praktikojnë besimin e tyre, të jenë të sigurt, të mos shqetësohen për ndërveprimet e tyre financiare dhe të mund të shprehin bindjet e tyre. Në fakt, të gjitha rregullat, ligjet dhe rregulloret e Islamit janë vendosur në fakt për të siguruar, garantuar dhe rregulluar këto liri.

Liritë e komunitetit janë të ndryshme; disa ndahen nga të gjithë dhe për disa bien dakord. Ndërsa disa janë reciprokisht përfshirëse, disa mund të bien ndesh ose të kundërshtojnë liritë e të tjerëve. Duke kujtuar pasojat e mundshme dhe premtimet e shpërblimeve në ahiret, Islami synon të parandalojë konflikte të tilla duke urdhëruar virtytin dhe ndalimin e veseve.

Një genie njerëzore, është me të vertete e lire, atehere kur prania e saj në një komunitet respektohet. Një individ i lirë mund të gëzojë mundësitë e avancimit dhe zhvillimit, në sferat materiale dhe jomateriale. Prandaj, ajo që i bie një personi të tillë të lirë është të respektojë dhe respektojë të drejtat dhe liritë e të tjerëve dhe t'i mbrojë këto të drejta ashtu siç mbrohen të drejtat e tij. Individët e lirë kërkojnë barazi.

Është ndër të drejtat e dikujt të diskutojë dhe të debatojë me të tjerët në lidhje me mendimet dhe besimet e tyre, edhe për të ngritur kundërshtime në dritën e besimit dhe besimit të dikujt. Megjithatë, nuk lejohet të shkaktojë ndonjë dëm ndaj të tjerëve, as të tallet me atë që ata e konsiderojnë të shenjtë apo të tallen me simbolet e feve të tyre. Përkundrazi, duhet respektuar ajo që ata mbajnë lart. Nga ana tjetër, dikush mund të presë që të tjerët të respektojnë atë që ju e konsideroni të shenjtë.

Duke hedhur dritë mbi këtë temë, Zoti thotë: "Dhe mos i shani ata që adhurojnë tjetërkend pos Zotit, se ata e shajnë Zotin me armiqësi pa dituri." (Kur'an 6:107-8). Dhe i Lartësuar i gjithashtu tha: "Fto në rrugën e Zotit tënd me urtësi dhe udhëzim të mirë dhe diskuto me ta në mënyrën më të mirë" (16:125). Ai gjithashtu shtoi: "Mos u grindni me ithtarët e librit përveç në mënyrën më të mirë, përveç atyre që bëjnë padrejtësi mes tyre" (29:46).

Struktura kryesore e lirisë, sipas Islamit, bazohet në detyrimin e sigurimit të jetës së individit përmes sigurimit të mjeteve dhe nevojave të tij themelore. Bazuar në këtë dispozitë, është e mundur që një individ të shfrytëzojë

të drejtën e tij të lirisë në mendim, besim, praktikë fetare dhe shprehje. Megjithatë, nëse komuniteti nuk arrin të kujdeset për të drejtat e të varfërve, të dobëtëve dhe të nevojtarëve, disa njerëzve do të privohen nga liritë e tyre. Kjo është veçanërisht e vërtetë kur shpërndarja e mirëqenies është jashtë ekuilibrit, sepse forcat dërmuese të varfërisë do të kufizojnë më tej liritë e të varfërve.

Zoti thotë në Kur'an: "Allahu me siguri do ta përsosë dritën e Tij, sado e urryer (që të jetë) për jobesimtarët. Ai është që e dërgoi të Dërguarin e Tij me udhëzimin dhe fenë e vërtetë për ta shfaqur atë mbi të gjitha fetë." (61:8-9).

"Përsosja e dritës" dhe "shfaqja e së vërtetës" mund të realizohen vetëm kur komuniteti dhe kombi bëhen një mishërim shembullor i vlerave që ata mbajnë. Këto vlera përfshijnë mëshirën, paqen, respektin, solidaritetin, unitetin, prosperitetin, vërtetësinë dhe cilësi të tjera të larta morale. Në komunitetin ku manifestohen të gjitha këto vlera, konceptet besimore përkthehen në sjellje dhe vlera estetike. Që kjo të jetë e mundur, anëtarët e komunitetit duhet të jenë të vetëdijshëm për të drejtat e tyre dhe mënyrat për t'i fituar ato. Rrjedhimisht, komunitetet do të angazhohen për ruajtjen e këtyre të drejtave – dhe më pas shtrirjen e tyre në shtete apo kombe të tjera. Ashtu siç duhet jetuar në mënyrë të drejtë, duhet të mbështeten kombet dhe komunitetet e tjera që përpiqen të fitojnë të drejtat e tyre njerëzore, prosperitetin dhe lirinë; kjo është një pjesë e pandashme e të qenit një komunitet shembullor.

Kur cilësitë dhe vlerat morale janë të rrënjosura fort në një komunitet dhe në ndërgjegjen e njerëzve, këto vlera do të shihen në sjelljet, veprimet dhe qëndrimet e atyre që i udhëheqin ata të bëhen "njeriu i përsosur" i cili është i pajisur potencialisht me aftësitë për të marrë mesazhin qiellor dhe për të përfituar prej tij. Përparimi dhe qytetërimi i një komuniteti janë në raport të drejtë me fisnikërinë e vlerave morale që zotëron.

Islami nuk e la çështjen e moralit të një komuniteti në vullnetin e individëve. Përkundrazi, ai vendosi disa limite dhe kufij mbi liritë dhe vendosi rregulla e rregullore për të krijuar një atmosferë morale. Ai gjithashtu përcaktoi një sërë masash ndëshkuese për të garantuar sigurinë dhe bashkëjetesë paqësore në shoqëri.

Duke ia besuar të drejtat e nevojtarëve dhe të varfërve shoqërisë në përgjithësi, mund të thuhet gjithashtu se Islami urdhëron një sistem sigurimi shoqëror. Si një zgjerim i këtyre të drejtave, Islami ka përcaktuar dhënien e lëmoshës (zekatit) nga të pasurit dhe stimuj të tjerë ligjorë për dhënien e bamirësisë përmes zotimeve (nedhrit), shlyerjeve (keffaret) dhe kompensimeve financiare. Në këmbim, për të mbrojtur të drejtat e njerëzve të pronës, Islami ka vendosur gjithashtu një sistem penal kundër krimeve si vjedhja, rebelimi dhe vrasja të cilat rrezikojnë sigurinë dhe unitetin e një komuniteti, ndërkohë që minojnë vlerat e tij etike.

Sistemi moral që parashtrohet Islami është unik në këto aspekte:

1. Burimi i sistemit moral të Islamit është shpallja hyjnore: Kur'ani dhe Suneti. Në këto dy burime, ka kritere dhe objektiva të gjera që rregullojnë sjelljen e një personi në univers në përputhje me një sistem fisnik të një morali të lartë.

2. Karakteri i mirë fitohet me përpjekje. Mundësia për të avancuar dhe për të fituar nivele të larta morale është e hapur për të gjithë njerëzit dhe të gjithë popujt. Të gjithë nisin nga një pikë e përbashkët ku të gjithë janë të barabartë në këtë garë për një të mirë më të lartë, duke qenë se ata janë të gjithë fëmijët e Ademit (a.s.). Në dritën e kësaj, transmetohet se sahabiu i Profetit Muhamed a.s., Ebu Said el-Hudri ka thënë: "Disa nga njerëzit e ensarëve kërkuar diçka nga i Dërguari i Zotit dhe ai ua dha atyre. Pastaj ata e kërkuar përsëri dhe ai ua dha atyre derisa harxhoi gjithçka që kishte. Ai tha: "Po të kisha diçka, nuk do ta mbaja larg teje. (Kujto) Kush përmbahet nga pyetja e të tjerëve, Allahu do ta kënaqë atë, e kush përpiqet të vetë-mjaftohet, Zoti do ta bëjë atë të vetë-mjaftueshëm. Dhe kushdo që bën durim, Allahu do ta bëjë të durueshëm. Askujt nuk mund t'i jepet një bekim më i mirë dhe më i madh se durimi."

3. Ky sistem moral karakterizohet gjithashtu në mënyrë unike nga qëndrueshmëria dhe stabiliteti. Arsyeja për këtë është se morali në Islam ka një "element adhurimi" (te'abudi) në të cilin njeriu kërkon kënaqësinë e Zotit të tij. Prandaj arsyeja e moralit buron nga fakti se ai kërkohet nga i Plotfuqishmi dhe për rrjedhojë nuk është thjesht një mënyrë ndërveprimi me të tjerët bazuar në parime dhe interesa utilitare. Në lidhje me këtë, sahabiu i Profetit a.s., Ebu Hurejra, transmeton se Muhammedi (a.s) ka thënë: "Qoftë i mjerë, adhuresi i dinarit dhe dirhemit dhe adhuresi i mantelit të mëndafshhtë me vija. Nëse i jepet diçka, ai është i kënaqur; por nëse jo, ai është i pakënaqur" (Buhariu, Rikak).

4. Morali islam dallohet gjithashtu duke qenë gjithëpërfshirës dhe plotësues i të gjitha aspekteve të jetës, publike dhe private, nga marrëdhënia e dikujt me Zotin tek ato me qeniet e tjera njerëzore, madje deri në nivelin e ndërveprimeve të tij shtëpiake.

5. Vlerat morale në Islam tregojnë për forma ideale, por ato janë gjithashtu të zbatueshme dhe realiste. Ato nuk e detyrojnë një person të bëjë diçka që është përtej aftësive të tij ose të saj. Zoti ka thënë në Kur'anin Famëllartë: "Andaj, sa të keni mundësi ruhuni prej dënimit të Allahut, dëgjoni, respektoni dhe jepni për të mirën tuaj, e kush i ruhet lakmisë së vetvetes, të tillët janë të shpëtuarit." (64:16).

4. Morali islam dallohet gjithashtu duke qenë gjithëpërfshirës dhe plotësues i të gjitha aspekteve të jetës, publike dhe private, nga marrëdhënia e dikujt me Zotin, ato me qeniet e tjera, madje deri në nivelin e ndërveprimeve të tij.

5. Vlerat morale në Islam rezultojnë për forma ideale, por ato janë gjithashtu të zbatueshme dhe realiste. Ato nuk e detyrojnë një person të bëjë diçka që është përtej aftësive të tij ose të saj. Zoti ka thënë në Kur'an: "Andaj, sa të keni mundësi ruhuni prej dënimit të Allahut, dëgjoni,

respektoni dhe jepni për të mirën tuaj, e kush i ruhet lakmisë së vetvetes, të tillët janë të shpëtuarit." (64:16).

Një varg tjetër thotë: "Ajo që unë kërkoj është vetëm t'i rregulloj gjërat aq sa të mundem. Suksesi im në detyrën time varet vetëm nga Zoti. Tek Ai kam vendosur besimin tim dhe Atij i drejtohem gjithmonë me gjithë zemër" (11:88).

Zoti gjithashtu tha: "Por me atë që ju ka dhënë Zoti, kërkon vendbanimin e botës tjetër (duke shpenzuar në lëmoshë dhe në qëllime të tjera të mira), pa harruar pjesën tuaj (që Zoti e ka caktuar) në këtë botë. Bëju mirë të tjerëve ashtu siç të ka bërë mirë Zoti (nga hiri i Tij i pastër). Mos kërkon prishje dhe ngatërresa në tokë, sepse Zoti nuk i do ata që bëjnë prishje dhe ngatërresa." (28:77).

6. Së fundi, morali islam është universal dhe dinamikisht i gjallë. Ato janë të përshtatshme për të gjitha qeniet njerëzore. Përfitimi i respektimit të këtyre moraleve do t'u kthehet të gjithë njerëzve, pavarësisht nëse janë muslimanë apo jo. Kjo rrjedh nga fakti se Islami është një fe që solli sisteme, rregulla dhe etikë universale dhe gjithëpërfshirëse. Për të theksuar më tej universalitetin e Islamit, Zoti tha: "Por ai nuk është tjetër veçse një Përkujtues për të gjitha qeniet" (68:52) dhe, "O njerëz, me të vërtetë unë jam një i dërguar i Zotit i dërguar për të gjithë ju." Në Kur'an, Profeti a.s. përmendet si "mëshirë" për të gjithë: "Ne nuk të dërguam ty (o Muhamed) veçse si mëshirë të pashoqe për të gjitha botët" (21:107). Transmetohet se Profeti a.s. ka thënë: "Muslimani është ai nga gjuha dhe dora e të cilit njerëzit janë të sigurt, dhe besimtari është ai që njerëzit i besojnë jetën dhe pasurinë e tyre" (Sahih Ibn Hibban). Profeti a.s. gjithashtu ka thënë: "Njerëzit më të dashur të Zotit janë ata që janë më të dobishëm për njerëzit" (Taberani, el-Mu'xham'ul Kebir).

Mesazhi i Pejgamberit është i vendosur mbi bazat e sistemit moral të Islamit. Koncepti i dashurisë ndaj Zotit dhe dashurisë ndaj të Dërguarit të Tij është i lidhur me respektimin e një personi ndaj vlerave të ndershme dhe të spikatura etike dhe morale. Muahmedi (a.s) e përmbodhi të gjithë qëllimin e dërgimit të tij si plotësimin dhe përsosjen e karakterit të mirë (Imam Malik, Mueatta). Pejgamberet para tij e filluan misionin dhe ai e përfundoi atë – ose siç përshkroi ai (a.s) përmes një analogjie, të gjithë pejgamberet punuan së bashku për të ndërtuar një ndërtesë dhe vetëm një tullë mungonte, dhe ai (a.s) ishte ajo tullë që mungonte.

Është transmetuar se Profeti a.s. ka thënë: "Më i dashuri dhe më i afërti prej jush për mua në Ditën e Kiametit do të jetë ai që është më i miri prej jush në sjellje" (Buhariu, Fadail es-Sahabe). Kur Profeti a.s. u pyet se çfarë i mundëson njerëzve të hyjnë në Xhenet, ai u përgjigj: "Devotshmëria dhe sjellja e mirë." (Tirmidhiu, Birr dhe Sila). I Dërguari a.s. i kategorizoi sjelljet e mira si adhurie përmes të cilave një person mund të fitojë shpërblime të mëdha shpirtërore si dikush që është në namaz të vazhdueshëm ditë e natë: "Me karakterin e tij të mirë besimtari do të arrijë shkallën e atij që fal natën dhe agjëron ditën."

Përshtati: Haki Sahitaj



Disa pyetje dhe përgjigje rreth

HAXHIT DHE KURBANIT

1- A është Haxhi një rit pagan?

Disa prej jo-myslimanëve priren t'ia mbushin mendjen vetes se Haxhi është një rit i pastër pagan apo një formë e idhujtarisë. Ky hamendësim ka qenë praktikuar nga idhujtarët arabë përpara Islamit, dhe që Islami e fshiu nga faqja e dheut. Ky hamendësim mbështetej në faktin se Qabja ka qenë vendi ku strehoheshin së paku 360 idhuj. Sidoqoftë, kjo është përqasje mashtruse e fakteve dhe e të dhënave. Pasi nuk kanë qenë idhujtarët e Mekës, por profeti Ibrahim (paqja qoftë mbi të!) që nisi veprimtarinë e Haxhit qysh asaj kohe. Në të kundërt, ishin pikërisht pasardhësit e Ibrahimit dhe Ismailit (paqja qoftë mbi ta!) që e shndërruan Qaben e Shenjtë të Allahut, në një panteon vigan.

Ishte pikërisht kjo radhë idhujtarësh që futi ritet pagane në pelegrinazhin e pastër islam. Nderimet e bekimet i takojnë Profetit Muhamed (paqja qoftë mbi të!), vulës së profetëve dhe të fundit të linjës së profetëve që zë fill me Ibrahimin (paqja qoftë mbi të!), që ishte i pari që e mbajti të pastër Qaben nga zotat.

Në fakt, mysli-manët janë ndjekësit e vërtetë të besimit të profetit Ibrahim dhe vulës së profetëve, profetit Muhamed (paqja qoftë mbi të!), pasi Haxhi në Mekë është një trashëgimi e vlefshme, ashtu si dhe një shtyllë e besimit.

2- A çlirohet dikush nga detyrimi i adhurimeve që janë farz ose vaxhib nëse nuk i kryen vetë këto, por cakton si përfaqësues (vekil) një tjetër që t'i kryejë në emër të tij?

Për sa u përket namazit dhe agjërimit, si adhurime që kryhen vetëm fizikisht, caktimi i përfaqësuesit, në mënyrë absolute, nuk lejohet. Askush nuk mund të falë namaz apo të agjërojë në vend të dikujt tjetër. Kryerja me përfaqësim e adhurimeve që duhen kryer fizikisht, nuk e çliron individin nga përgjegjësia e kryerjes së tyre.

Për sa u përket obligimeve si zekati, sadakaja apo kurbanit, të cilat kryhen me mall, caktimi i një përfaqësuesi është absolutisht i lejuar. Dikush, sikurse mund t'i japë vetë zekatin apo sadakanë dhe të therë kurbanin, mund t'i kryejë këto edhe nëpërmjet dikujt tjetër.

Për sa i përket Haxhit, që kryhet edhe fizikisht, edhe me pasuri, për dikë që është i përgjegjshëm, por që nuk i ka mundësitë fizike për ta kryer vetë, lejohet që të caktojë përfaqësues dikë tjetër. Në të kundërt, caktimi

i përfaqësuesit nuk është i lejuar.

Nëse për arsye si vdekja, moshë e madhe, lëngatat e gjata, mosgjendja e personave të përshtatshëm për të shoqëruar gratë në udhëtim, nuk janë mundësitë e kryerjes së Haxhit, dikush tjetër mund të dërgohet përfaqësues në emër të personave që kanë arsyet në fjalë. Ata që e kanë Haxhin obligim dhe që nuk mund ta kryejnë atë për shkak të arsyeve të sipërpërmendura, duhet të dërgojnë një përfaqësues (vekil) për të bërë Haxhin e tyre.

Ata që, megjithëse e kanë Haxhin obligim, as nuk mund të shkojnë vetë dhe as nuk mund të dërgojnë përfaqësues, përpara vdekjes duhet të lënë porosi testamentare që dikush të bëjë Haxhin në emër të tyre.

Në lidhje me kryerjen e Haxhit me përfaqësues, një hadith i transmetuar nga Abdullah b. Abbasi e ndriçon çështjen si vijon: "Një grua prej fisit Hasa, në vitin e Haxhit të Lamtumirës, shkoi tek i Dërguari i Allahut, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, dhe e pyeti: "O i Dërguari i Allahut! Urdhri i Zotit të Madhëruar që njerëzit të kryejnë Haxhin, babait tim i mbërri në një moshë shumë të thyer, aq sa s'mund të qëndronte mbi kafshë. Nëse unë bëj haxh në emër të tij, a i shlyhet borxhi?" I Dërguari i Allahut, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, iu përgjigj: "Po, i shlyhet." (Buhari, Haxh, 1,2; Muslim, Haxh, 7/3).

3- Cila është historia e Gurit të Zi?

Më shumë se pesë mijë vjet më parë, babai i profetëve, Ibrahim (paqja qoftë mbi të!) ndërtoi Qaben duke përmbushur urdhrin e Allahut. Ai (paqja qoftë mbi të!) e ndërtoi edhe me ndihmën e djalit të tij më të vogël, Ismailit. Ja se si përshkruhet në Kur'an ndërtimi i Qabes:

"Edhe kur Ibrahim dhe Ismaili duke i ngritur themelet e shtëpisë (Qabes, luteshin): "Zoti ynë, prano prej nesh se me të vërtetë Ti je që dëgjon dhe di!"

Babai dhe djali, besimtarë të sinqertë të Zotit Një, po përpiqeshin ta ndërtonin me zemër të ngrirë (për mysli-manët kjo është shkalla më e lartë e përkushtimit, pasi frika dhe droja shprehin besimin e pastër te Allahu). Ata kishin droje se Allahu nuk do t'ua pranonte shërbesën e tyre të përvuajtur. Ky është thelbi i monoteizmit, një shembull që duhet ndjekur nga të gjithë mysli-manët. Kur ndërtesa kishte shkuar gjer në një farë lartësie, Ibrahim (paqja qoftë mbi të!) i kërkoi të birit një copë gur për

të shënjuar cepin e ndërtesës. Ndërkohë që i biri po kërkonte gurin, kryeengjëlli Xhibril u shfaq me një gur nga Xheneti.

Ibrahimi (paqja qoftë mbi të!) e mori gurin dhe e vuri në vendin e duhur, dhe i tillë qëndron atje sot e kësaj dite. Është një gur qiellor, nuk është aspak gur tokësor. U zgjodh prej Allahut për Shtëpinë e Tij të Shenjtë (Qaben).

4- A është puthja e Gurit të Zi aq thelbësore?

Dihet mirë procedura e bërjes së tavafit, që konsiston në rënien qark të Qabes për shtatë herë rresht. Çdo rrotullim nis nga cepi i Qabes, ku është vendosur Guri i Zi. Kjo mund të dallohet nga cilido haxhi që viziton Xhaminë e Shenjtë, edhe sikur ta ketë për herë të parë.

Le të mos harrojmë se mijëra apo dhjetëra mijëra njerëz ka raste, që i bien rreth Qabes në të njëjtën kohë. Jo vetëm që është e pamundur për cilindo të pranishëm të puthë apo të prekë Gurin e Zi, madje ka raste që edhe nuk mund ta shohësh dot gurin, për shkak të distancës që të krijohet me të. Është më se normale që në këto raste të mbetet vetëm të kthehesh nga cepi verilindor i ndërtesës, dhe një zgjatje dore për nga Guri i Zi, në formë përshëndetje, është një veprim më se i mjaftueshëm.

5- A theret kurban për të vdekurit?

Nëse dikush dëshiron që të therë kurban me qëllimin që sevapi i therjes së tij t'i shkojë një personi të dashur a të afërt që ka vdekur, mund ta bëjë këtë. Ashtu sikurse në emër të një njeriu të vdekur mund të jepet pas vdekjes sadaka apo të bëhet haxh, mund të theret edhe kurban në emër të tij. Kështu, Profeti ynë ka therur kurban në emër të njerëzve nga umeti i tij që nuk mund të therrnin kurban. (Taberani, Muxhemu'l-Kebir, 3/182; Hejthem, Mexhmau'z-Zevaid, 4/23)

Në Sunenin e Ebu Davudit, nën titullin përmbledhës "Therja e kurbanit pas vdekjes së dikujt", shënohet:

"Aliu (r.a.) therte dy desh, ndër të cilët njërin për Profetin. Kur e pyetën për këtë, tha: "I Dërguari i Allahut më ka lënë amanet që të ther kurban për të sa të jem gjallë. Kurrsesi nuk e lë pa bërë këtë." (Ebu Davud, Edahi, 1; Hakim, Mustedrek, 4/255).

Fakti se Profeti ynë i ka lënë porosi Aliut (r.a.) që të therë kurban në emër të tij është argument që një gjë e tillë lejohet. Për këtë arsye, ata që kanë mundësi çdo vit mund të therin si kurban në emër të Profetit tonë të dashur së paku një dele/dash ose të marrin pjesë në një të shtatën e një kurbanit lopë. Kjo do të ishte një sjellje

plotësisht e pranueshme dhe me vend.

Nëse dikush, me të hollat që fiton vetë, ther një kurban për t'i dhuruar sevapin një të afërmi të vdekur, nga mishi i atij kurbanit mund të ushqehet edhe vetë, sikurse t'i dhurojë edhe të tjerëve. Gjithashtu, nuk është kusht një kurban me këtë nijet të theret vetëm në ditën e Bajramit. Mund të theret në çdo kohë. Nëse theret dhe u shpërndahet të varfërve në ditën e Arafatit, është edhe më mirë, pasi në ditën e Bajramit të Kurbanit, sido që të jetë, të varfërve do t'u shpërndahet mish. Nëse theret dhe shpërndahet në ditën e Arafatit, kjo mundëson që ata të ushqehen me mish edhe atë ditë.

Nëse dikush që është ndarë nga jeta ka lënë porosi testamentare qysh më parë që të theret kurban në emër të tij, atëherë ky kurban duhet të theret në ditët e Bajramit. Prej këtij mishi nuk mund të hajë askush nga familja apo të afërmit, por duhet dhënë i gjithi për sadaka. Edhe nëse personi i ndarë nga jeta nuk ka lënë ndonjë porosi, por nga të hollat e lëna prej tij theret kurban, veprohet njëllë si në rastin e kurbanit për të cilin është lënë porosi. Edhe në mos pastë porosi testamentare apo betim (nedhr), sipas shumicës së juristëve myslimanë, me përjashtim të shafive, mund të theret kurban në emër të tij, me qëllimin për t'i dhuruar të vdekurit sevapin përkatës.

6-A mund të jepet sadaka në vend të therjes së kurbanit?

Çdo adhurim ka vendin e vet. Zekati ka vendin e vet, sadakaja të vetin dhe kurbanit të vetin. Sidoqoftë, nëse në ditët e Kurban Bajramit, kur theret kurban, nuk është arritur të theret kafsha e caktuar për këtë, atëherë ajo jepet sadaka në qoftë e gjallë ose dhurohet si sadaka vlere e saj nëse kafsha ka ngordhur. Adhurimet financiare që kryhen për afrim ndaj Allahut (kurbijet) janë dy lloje: një pjesë e tyre, si sadakaja apo zekati, i dhurohen tjetrit në dorë; ndërsa pjesa tjetër është në formën e nxjerrjes nga duart, të sakrifikimit, si në rastin e liritimit të skllëvërve dikur. Në rastin e kurbanit, janë të dyja. Kurbanit e siguron afrimin tek Allahu fillimisht duke therur kafshën, çka, si sakrifikim, hyn në llojin e dytë. Më pas mishi dhurohet si sadaka dhe kjo është dhurim i llojit të parë. Por ajo që mbetet thelbësore është therja e kurbanit për hir të Allahut. Nëse kjo nuk bëhet, detyrimi i kurbanit nuk është çuar në vend. Për këtë arsye, në ditët e Bajramit të Kurbanit me dhënien e të hollave në vend të therjes së kurbanit, obligimi nuk është çuar në vend.



HAXHI

Një këndvështrim retrospektiv

Pas një ndërprerje të gjatë të fesë në Shqipëri, më 18 Qershor 1991, do të nisej drejt vendeve të shenjta grupi i parë i haxhilerëve nga Shqipëria, i përbërë prej 165 vetave, për të përmbushur një nga pesë shtyllat e fesë Islame: Haxhin. Ky ishte një lajm madhështor dhe një hap tepër i rëndësishëm përse i përket lirisë së besimit për besimtarët myslimanë, të cilët ishin përballuar për Qaben dhe Medinen me një mall gjysmëshekullor, të cilëve u qe mohuar e drejta e praktikimit të fesë bashkë me ritet përkatëse ashtu siç ka urdhëruar Allahu i madhëruar.

Delegacioni i udhëtimit për në Arabinë Saudite kryesohej nga i nderuari Hafiz Sabri Koçi, i cili ishte edhe kryetari i parë i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë pas rënies së komunizmit dhe hapjes së lirisë fetare në vend. Lajmi për mbërritjen e delegacionit nga Shqipëria kishte bërë jehonë në periodikët dhe gazetatat e ditës dhe kishte ngjallur interes tek të gjithë vizitorët e tjerë myslimanë të atjeshëm, dhe veçanërisht edhe tek paria e Mbretërisë së Arabisë Saudite, ku haxhinjtë shqiptarë ishin të ftuar duke u cilësuar si miq të mbretit dhe qenë të parët që u pritën në vizitë.¹

Sigurisht, asokohe e gjithë bota ishte e interesuar për ndjesitë e veçanta që ndjenin haxhilerët shqiptarë gjatë këtij udhëtimi, sepse ne ishim vendi i parë në botë ku si pasojë e pushtetit feja u ndalua me ligj për një periudhë aq të gjatë. E megjithatë, asgjë nuk e shuajti prushin e besimit në zemrat e besimtarëve të cilët e ruajtën fenë dhe nisën hapat e rimëkëmbjes fetare në vend.

Pasi u kryen ritualet e haxhit dhe pasi të gjithë haxhilerët kishin shijuar madhështinë dhe mrekullinë e Qabes, shtëpisë së Zotit, të gjithë besimtarët festuan ditën e Kurban Bajramit. Vendi ynë pati mirësinë që të përfaqësohej nga një figurë e shquar dhe e vuajtur si Hafiz Sabri Koçi, i cili, në mbledhjen e kryetarëve të bashkësive fetare Islame nga e gjithë bota, me rastin e festës së Bajramit, pati nderin të mbante fjalimin e tij, duke shpjeguar edhe më qartë rëndësinë e lirisë së fesë dhe mirësinë që Zoti kishte bërë mbi popullin shqiptar.

Grupi i dytë i haxhilerëve shqiptarë

Më 6 qershor të vitit 1992, për të dytën herë radhazi shqiptarët do të kishin mundësinë që të kryenin sërish ritualin e Haxhit në Arabinë Saudite. Grupi i dytë i haxhilerëve do të përbëhej prej 303 vetëve, të cilët patën mundësinë të udhëtonin për në vendet e shenjta e të gjendeshin përballë Qabes, e cila është Kibleja e të gjithë myslimanëve të botës, nga e cila kthejnë fytyrat, drejtojnë sytë, thonë fjalët më të zgjedhura, fjalët e Allahut me rastin e çdo namazi, kur i falen Allahut (xh. sh.).

Pelegrinazhi është kushti i pestë i fesë Islame dhe së

1. *Me Haxhinjtë shqiptarë në Arabinë Saudite*, pjesë nga dokumentari televiziv i Haxhit të parë në vitin 1991, arkivi i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë.

bashku me Dëshminë (Shehadetin), Namzain, Agjërimin dhe Zekatin, përbëjnë 'godinën' e plotë të Islamit. Me plotësimin e të gjitha këtyre kushteve, myslimani e siguron lumturinë në këtë botë dhe në botën tjetër. Kryerja e Haxhit është detyrim për këdo që e ka mundësinë dhe i ka përmbushur kushtet financiare për të përballuar udhëtimin gjer në Mekë.

Udhëtimi për në vendet e shenjta, për në Mekën fisnike dhe në qytetin e bukur të profetit Muhamed (a.s.) që është Medina, për çdo besimtar mysliman është një ëndërr e bukur dhe e vyer, pasi atje përjetohet më nga afër e gjithë historia e Islamit me dëshmitë dhe vërtetësitë e pakontestueshme të saj, ndjehet më nga afër historia e profetit të fundit, Muhamedit (a.s.), atje është vendi nga ku u përhap shpresa dhe që atje Zoti hapi dyert e mëshirës për të gjithë njerëzimin që të mund të mësonin prej Kur'anit të zbritur, mësimet dhe udhëzimet e Allahut, dhe kështu, deri në Ditën e Gjykimit, njerëzimi mbarë do të ketë mundësinë të ndjekë Islamin dhe rregullat e lumturisë së kësaj bote dhe të Ahiretit.²

Nënshkrimi i marrëveshjes së Haxhit në 2011

Dy vitet e para pas komunizmit, haxhi organizohet nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë me ndihmën e vendeve mike. Kurse në vitin e tretë (1993), haxhi organizohet nga shoqatat, gjë në të cilën Komuniteti Mysliman vë re probleme të ndryshme në përzgjedhjen e personave për haxh, si jo besimtarë të mirë, ndërkohë që në pritje ishin shumë besimtarë që falnin pesë vaktet.³ Edhe gjatë viteve vijuese, kanë qenë agjenci të ndryshme që janë aktivizuar me organizimin dhe mbarëvajtjen e të gjitha procedurave të haxhit.

Me datë 22.06.2011, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë nënshkroi me Ministrinë e Haxhit të Mbretërisë së Arabisë Saudite, akt-marrëveshjen për organizimin e ritualit të Haxhit për vitin 2011. Në emër të Komunitetit Mysliman akt-marrëveshja është firmosur nga ish Kryetari i KMSH-së, H. Selim Muça. Përveç të tjerave, në akt-marrëveshje bëhet e ditur se ekskluzivitetin për organizimin e Haxhit në Shqipëri do ta ketë vetëm institucioni zyrtar përfaqësues që është Komuniteti Mysliman i Shqipërisë.⁴ Kjo akt-marrëveshje rinovohet çdo vit nga të dyja palët.

2. Nasuf T. Dizdari, *Grupi i dytë i haxhilerëve shqiptarë*, Revista Drita Islame, Nr. 14, Viti i I i botimit, 10.07.1992.

3. Informacion mbi marrëdhëniet me shoqatat e ndryshme bamirëse islamike arabe, datë 15.06.1993, arkivi i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë.

4. *Aktivitetet, vjetar 2010-2011*, Vëllimi I, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, Tiranë 2011, f. 95.

AMËSIA

NUK ËSHTË STATUS,
ËSHTË PRIVILEGJ



Amësia nuk është status. Është privilegj. Është privilegj i gjinisë femërore ndër të gjitha krijesat. Tek qenia njerëzore merr një ngjyresë të fortë emocionale. Kushdo femër që është bërë nënë e kujton me mall lajmin se do të bëhet nënë për herë të parë. Është gëzim i papërshkrueshëm kur kupton se brenda teje po merr jetë një qenie tjetër. Nuk shqetësohesh nëse do të jetë djalë apo vajzë. Gëzimi që do të bëhesh nënë e eklipson gjininë e qenies që pritet të vijë në jetë dhe të mbushë me gëzim zemrat e prindërve, gjyshërve e më gjerë. Emocione të forta mbështjellin qenien tënde femërore. Pranon ndryshimet fizike dhe psikologjike. Pranon sfidat e shtatzanisë dhe i përballon sikur të mos jenë duke ndodhur. Harron vetveten dhe mendon gjithë kohën për krijesën që rritet çdo ditë me gjakun dhe shpirtin tënd. Çdo ditë e përkëdhel dhe i jep lajmin e bukur se të gjithë mezi po e presin ardhjen e tij apo saj. Sa e emocionuar je ndjerë kur për herë të parë këmbët e vogla të krijesës së re, të kanë shkëlmuar të kanë lënë pa gjumë. Kushedi në sa e sa biseda ke hyrë me të, duke i folur pa pushim për jetën që e pret, gëzimet e hidhërimet e saj, dhe se si me kurajo e guxim do të ndërtojë jetën e vet. Krijesa e re të shkëlmon për të të thënë se të kuptoi shumë mirë dhe se është emocionuar që ka një nënë kaq të shqetësuar e të dhembshur. Ditët, javët, muajt kalojnë dhe tashmë pret me padurim të dëgjosh zërin e gjakut dhe shpirtit tënd.

Kalon vështirësi, rrezikon dhe jetën tënde, por përsëri shqetësimi yt mbetet jeta dhe shëndeti i krijesës së re. Ja ku dëgjohen të qarat e para. Pak rëndësi ka në është djalë apo vajzë. Ti harron dhimbjet dhe sflitjet. Merr në kraharor gjakun tënd. Ndjen aromën dhe ngrohtësinë e tij dhe ndihesh sikur një copë parajse ka zbritur në kraharorin tënd. Qan nga gëzimi e mallëngjehesh kur fëmijën e porsaardhur në jetë duhet ta vendosin në dhomën përkatëse. Nuk e dëshiron shkëputjen qoftë edhe për disa sekonda, por ja që duhet të ndjekësh rregullat. Vjen sërish në folenë tënde prej nga ku dole që të kthehesh me amësinë si privilegj. Duron pafundësisht

çdo "tekë" të fëmijës dhe i jep gjithë përkushtimin tënd, që të mos mundohet për asnjë çast në botën e re. Lodhesh, lë veten pas dore. Humbet bukurinë fizike përkohësisht, por jo hijeshinë dhe elegancën e një nëne të re. Megjithatë në syrin tënd këto nuk kanë aspak rëndësi, sepse të gjitha këto janë bërë kurban në altarin e dashurisë për krijesën e re. Përballë kësaj lumturie që të bën të ndihesh si me krahë, nuk kursehesh aspak për të mëkuar me dashuri fëmijën tënd. E ndërsa e mëkon thur ëndërrat më të bukura për të, për jetën që do të ketë, për sukseset që do të arrijë. Kurrë nuk mendon për sfidat, vështirësitë që do të përballojë, sepse një nënë nuk duron dot që fëmija i saj qoftë dhe në përfytyrime të pësojë vuajtje apo vështirësi në jetë. Ti e di që kurrë nuk do të ketë vetëm lumturi në jetë, por qysh pa nisur të hedhë hapat e parë si nënë që je përpiqesh ta mbrosh fëmijën.

Koha rrjedh dhe ti krijesë e dashur dhe e dhembshur mbetesh gjithmonë e shqetësuar për të, edhe pse tashmë mund të jetë rritur e burrëruar apo rritur e bërë një vajzë që pret të ndjekë shembullin tënd. Çdo sekondë që nuk është para syve të tu shqetësimi kaplon qenien tënde. Nuk vë gjumë në sy. Qetësoshesh vetëm kur është mirë krijesa që të dha privilegjin e amësisë. Gëzohesh kur gëzohet fëmija yt. Mërzitësh kur mërzitet fëmija yt. Shqetësohesh kur mendon se diçka e keqe mund t'i ngjasë. Vetëm kur e mendon dridhesh nga ankthi. Këto dhe shumë të tjera janë shenja qiellore se në zemrën e nënës janë vendur thesaret e botës. Po kush mund t'i vlerësojë këto thesare nëse heq dorë nga amësia? Sot je një nënë, por dikur ishe një vajzë plot më ëndrra. Ndoshta nuk t'u plotësuan të gjitha ëndrrat, por a mund t'i plotësohen gjithëkujt të gjitha ëndrrat? Ndoshta jeta nuk të dha atë që prisje prej të mirave të saj materiale. Megjithatë mos harro se të dha privilegjin e amësisë. Të dha në dorë fatin e botës, pasi nga dashuria jote e pashtershme për fëmijën, do të edukohen fëmijë që do të ndjekin shembullin tënd dhe do ta çojnë emrin në lartësi ku edhe në dimrin më të egër ka vetëm rreze dielli.



Kurbani

NGA ASPEKTI JURIDIK

Personi që obligohet me therjen e një kurban duhet të jetë mysliman, me mendje të shëndoshë dhe adult, nuk duhet të jetë udhëtar dhe duhet të zotërojë mundësi financiare minimale të përcaktuara fetarisht për t'u quajtur i pasur. Por që adhurimi i tij të plotësohet, duhet të zbatojë disa kushte për sa i përket kafshës së kurbanit dhe therjes së saj.

Kafsha e zgjedhur për kurban mund të jetë dele, dhi, lopë, buall, deve dhe nga kafshët e tjera të ngjashme. Kjo është e pranuar unanimisht nga të gjithë dijetarët islamë. Ndërsa dykëmbëshet si: pula, rosa, pata, gjeli i detit etj., nuk pranohen e nuk vlejnë për kurban. Kafshët e lartpërmendura si të përshtatshme mund të theren si kurban nga të dyja gjinitë. Por për sa i përket familjes së deleve është më e pëlqyeshme të theret dashi.

Për kafshët si delet dhe dhitë, ato duhet të kenë mbushur një vit që të mund të pranohen si kurban. Vetëm nëse një dele 6 muajsh është e shëndetshme

dhe tregon për një vit, atëherë edhe ajo mund të pritët si kurban. Ndërsa dhia, duhet patjetër të ketë mbushur vitin. Kafshët si lopa dhe bualli, duhet të jenë mbi dy vjeç, ndërsa deveja, duhet të jetë mbi pesë vjeç.

Delja dhe dhia mund të theren si kurban vetëm në emër të një personi, ndërsa kafshët si lopa, kau dhe bualli mund të theren si në emër të një personi, ashtu edhe në emër të shtatë personave, që bien në ujdi me njëri-tjetrin. Pasi theret kurban, mishi ndahet ndërmjet tyre në mënyrë të barabartë.

Kafsha që theret si kurban me qëllim adhurimi, duhet të jetë e shëndetshme, e majme dhe me organe të rregullta. Kjo shërben si për qëllimin dhe mënyrën e adhurimit, ashtu edhe për rregullat e shëndetit. Për këtë arsye kafsha nuk duhet të ketë ndonjë mangësi që ta pengojë plotësimin e kushteve të kurbanit, si për shembull të jetë e sëmurë, e verbër, sakate, me brirë të shkukur ose të thyer, me bisht apo veshë të prerë dhe me pjesën e madhe të dhëmbëve të rënë.

Të gjitha adhurimet kryhen në kohën dhe sipas kushteve të caktuara nga Allahu. Kështu që kurbanit mund të theret nga mbarimi i namazit të bajramit deri në perëndimin e ditës së tretë (të bajramit).

Përgjithësisht dhe më e preferueshme është që kurbanit të theret në ditën e parë. Por ata që s'gjejnë rast për ta therur ditën e parë, mund ta therin edhe në ditët e tjera në vazhdim.

Kafsha që do të theret merret dhe pa e munduar shtrihet në drejtim të kibles nga ana e majtë. Kurbanin mund ta therë vetë personi ose mund t'ia lerë ndonjë tjetri. Ai që e ther nuk lejohet ta torturojë kafshën dhe thika që do të përdorë duhet të jetë e mprehtë. Profeti (a.s.) në lidhje me këtë pikë ka urdhëruar: "Kur të therni një kafshë, theni me butësi, ai që ther prej jush, le ta mprehë mirë thikën dhe mos ta mendojë kafshën". Thika mbahet me dorën e djathtë dhe në momentin e therjes thuhet "Bismilahi Allahu Ekber", duke e prerë kafshën në të dyja anët e damarëve të qafës. Nga sahabet Xhabiri transmeton se Profeti (a.s.) ditën e kurbanit theri dy desh me brirë dhe të majmë. Para se ta kryente këtë veprim ai tha: "Unë fytyrën time e drejtova nga Ai, i cili ka krijuar qiejt e tokën dhe unë nuk jam prej idhujtarëve (En'am, 79). Namazi im, kurbanit im, jeta ime dhe vdekja ime janë për Allahun, Zotin e botëve. Ai nuk ka asnjë shok dhe unë jam prej myslimanëve" (En'am, 162-163). O Zoti im, ky kurban është prej Teje dhe për Ty. Në emër të Muhamedit dhe ymetit të tij, Bismilahi Allahu Ekber." (Et-Taxh, III, 207).

Një kusht tjetër është që kafshës duhet t'i rrjedhë i tërë gjaku pasi të jetë therur. Për të mos e munduar shumë kafshën nuk fillohet rrjepja e lëkurës derisa ajo të mos lëvizë më.

Mishi dhe lëkura e kurbanit

Nga kurbanit i therur në Bajramin e Kurbanit mund të konsumojë mish i zoti, pasi edhe ai në ditën e Bajramit, si të gjithë njerëzit e tjerë, është mysafir i Zotit dhe mund të përfitojë nga bereqeti i sofrës së Allahut. Është sunet për personin që të hajë vetë nga mishi i kurbanit dhe t'i japë afërmve të tij dhe të varfërve. Profeti Muhamed (a.s.) në lidhje me këtë porositi: "Nga kurbanet, hani, shpërndani dhe ruani" (Buhari, Edebu'l-Mufred, I, 198). Dijetarët myslimanë kanë këshilluar që është mirë që mishi të ndahet në tre pjesë, ku një pjesë të veçohet për pjesëtarët e familjes, një pjesë t'u shpërndahet të varfërve dhe një pjesë t'u jepet fqinjëve ose të afërmve. Në Kur'anin fisnik, na bëhet e ditur se mund të bëhet një ndarje e tillë. "...hani nga mishi i tyre (kurbaneve) dhe ushqeni nevojtarin e të varfrin." (Haxh, 28).

Krahas kësaj, nëse dikush që ther kurban ka një familje të madhe dhe nuk i ka mundësitë ekonomike shumë të mira, atëherë është më e përshtatshme që ta mbajë të gjithë kurbanin në shtëpinë e tij, sepse nevoja

vetjake dhe e familjes ka përparësi ndaj nevojave të njerëzve të tjerë. Profeti (a.s.) duke tërhequr vëmendjen për këtë çështje, ka bërë të ditur se nevojtarit duhet të nisë dhurimin së pari nga vetja dhe nga familja e vet. (Muslim, Zekat, 41; Buhari, Zekat, 18; Tirmidhi, Zekat, 38).

Mishi, lëkura, dhjami, koka, leshi i kurbanit të therur për hir të Allahut nuk shiten. Nëse shiten, paratë e tyre duhen dhënë për sadaka. Madje nëse kafshës së kurbanit përpara se të theret i është marrë qumështi dhe i është qethur leshi, edhe vlera e këtyre duhet dhënë për sadaka, pasi kafsha e kurbanit me gjithë ç'përmban është përgatitur e ndarë për të fituar kënaqësinë dhe afrinë e Allahut.

Lëkura e kurbanit mund të mbahet në shtëpi për t'u përdorur për shtrojë, por më e mira është t'u jepet institucioneve humanitare. Në një hadith, Profeti, paqja qoftë mbi të, ka thënë se ai që e shet lëkurën e kurbanit që ka therur, do të mbetet pa shpërblimin që i premtohet therësit të kurbanit. (Hakim, Mustedrek, 2/422; Beyhaki, Sunenu Kubra, 9/294; Munavî, Feyzu'l-Kadîr, 6/93)

Në lidhje me këtë çështje, Aliu (r.a.) tregon: "I Dërguari i Allahut më dërgonte që të interesohem për devetë e kurbanit, duke më urdhëruar për të dhuruar prej mishit, lëkurës, leshit të tyre dhe për të mos e bërë pagesën e kasapit prej këtyre," duke shtuar më tej: "Pagesën e kasapit e bënim nga ana jonë." (Buhari, Haxh 122, Vekalet 1; Muslim, Haxh 348).

Edhe nëse këshillohet dhe preferohet që mishi i kurbanit të shpërndahet në zonën ku është bërë therja, nëse në vendbanime të tjera ka më shumë njerëz nevojtarë, mund të dërgohet edhe atje.

Pas therjes së kurbanit, ambienti duhet të pastrohet sa më mirë. Është e nevojshme që mbetjet e kafshëve të groposen sa më thellë në tokë dhe nëse është e mundur, asgjë të mos mbetet sipër. Një sjellje e tillë është shprehje e respektit për kafshën dhe njëkohësisht, është shumë e rëndësishme edhe për pastërtinë e mjedisit. Profeti ynë ka theksuar në shumë hadithe rëndësinë e mbajtjes së mjedisit të pastër. (Muslim, Taharet 1; Tirmidhi, Da'avat 91). Duhet bërë kujdes që shpërblimi i therjes së kurbanit dhe i shpërndarjes së mishit për nevojtarët të mos pakësohet duke shkaktuar papastërti në mjedis dhe duke cenuar, kështu, të drejtat e njerëzve të tjerë.

Nga Ebu Hurejre transmetohet se Profeti (a.s.) i ka paralajmëruar personat që kanë mundësi të therin kurban por nuk e bëjnë atë, në këtë mënyrë: "Ai që ka mundësi të therë kurban dhe nuk e bën këtë, të mos i afrohet faltores sonë" (Ibn Maxhe, Edahi, 2, Ahmed). Në këtë ditë feste nuk lejohet agjërimi i çdo lloji qoftë. Në lidhje me këtë Ibn Abasi transmeton se Profeti (a.s.) dërgoi një person të lajmërojë: "Mos agjëroni në këto ditë (ditët e teshrikut), pasi janë ditë në të cilat hahet, pihet dhe gëzohet me familjen" (Taberani).

URTËSITË E THERJES SË *Kurbanit*



Kurbani është një shprehje përkushtimi, sakrifice, singeriteti dhe nënshtrimi ndaj vullnetit hyjnor. Ky nënshtrim e përkushtim simbolizohet në mënyrë kulmore me Ibrahimin dhe Ismailin.

Ngjarja e treguar në Kur'anin fisnik (Safat, 100-107) paraqitet si një horizont në emër të bindjes dhe nënshtrimit ndaj urdhrave të Allahut për besimtarët. Ç'përkushtim, besim e bindje e jashtëzakonshme vërehet te Ibrahim?! Për vite të tëra zemra i ishte djegur nga dëshira për të pasur një fëmijë. Allahu i dhuroi një bir kur ishte në moshë të thyer. Më pas, kur djali e kaloi moshën e fëmijërisë dhe mbërriti në moshën që mund të rendte pas të atit, të shoqërohej e të punonte me të, Ibrahim pa në ëndërr se i duhej të flijonte të birin. Ai e kuptoi se kjo ëndërr ishte një shenjë prej Zotit të tij, që i urdhëronte të bënte të birin kurban. E pra, ajo që ai shihte në ëndërr ishte veç një shenjë e jo një zbulësë e qartë. E megjithatë, kjo ishte e mjaftueshme që Ibrahim të përulej përpara urdhrit të Allahut dhe t'i shprehte Atij bindje të plotë. Ndërkohë, ajo që po i kërkohej nuk ishte që ta dërgonte të birin në luftë apo t'i urdhëronte diçka që mund t'i kushtonte jetën, por ta flijonte me duart e veta. Ibrahim, në një dorëzim e nënshtrim të plotë, me paqe e qetësi të brendshme, iu drejtua të birit dhe pa se edhe ai gëzonte të njëjtin përkushtim e nënshtrim. Atë e bir, në kulmin e përkushtimit ndaj Allahut, iu vunë punës për ta çuar në vend atë që u kërkohej. Kur Ibrahim e përgatiti të birin duke e shtrirë për ta flijuar, Allahu i Lartësuar i bëri të ditur se e kaloi sprovën dhe i dërgoi një dash kurban për ta flijuar në vend të tij. Kështu, kujtimi i kësaj ngjarjeje të madhe që lartohet si pishtar i bukurisë së bindjes dhe i madhështisë së përkushtimit, vijohet sot e kësaj dite me traditën e therjes së kurbanit. Profeti ynë, duke tërhequr vëmendjen për këtë çështje, ka urdhëruar e ka thënë: "Thëni kurban, sepse therja e kurbanit është shembulli i Atit tuaj, Ibrahimit" (Ibnu Maxhe, Edahi, 3; Ahmed b. Hanbel, Musned, 4/368; Hakim, Mustedrek, 2/422).

Kurbani zhvillon shpirtin e bindjes e të përkushtimit ndaj Allahut. Në këtë mënyrë, njeriu mbart në vetvete sjelljen e nënshtrimit ndaj Zotit, përpiket të vërë në vend detyrën e mirënjohjes, i afrohet Allahut dhe kurban i kthehet në një shkak për këtë afri hyjnore.

Veç kësaj, kurban ka vlera të veçanta edhe në jetën shoqërore. Kurban nxit dhe zhvillon shpirtin e vëllazërimit, të ndihmës, të sakrificës e të mbështetjes tek njëri-tjetri. Ai ndihmon në zhvillimin e drejtësisë, siguron një ndihmesë domethënëse në kapërcimin e hendeqeve mes shtresave shoqërore dhe në njohjen, afrimin dhe shkrirjen mes individëve të niveleve të ndryshme.

Në jetën e njerëzve të varfër, që nuk janë në gjendje

të blejnë mish ose që mund të blejnë shumë pak të tillë, kuptohet qartë mirësia e bereqeti i këtij ibadeti. Kurban e mëson të pasurin që të dhurojë nga malli i tij për të fituar kënaqësinë e Allahut. Ai nxit ndihmën e ndërsjellë dhe bën të ndihet në shpirt kënaqësia e dhurimit dhe e ndihmës. Në këtë mënyrë, ai e çliron botën nga sëmundja e koprracisë, nga përkushtimi i tepruar ndaj pasurisë së kësaj bote.

Kurbani bëhet shkak që edhe i varfri, me ndihmën e njerëzve në gjendje më të mirë ekonomike, të falënderojë Allahun. Njeriu i varfër, në saje të kurbanit, çlirohet prej pesimizmit dhe armiqësisë që mund të ndiejë për arsye të shpërndarjes së të mirave materiale në këtë botë dhe kupton se shoqëria në të cilën jeton tregon vëmendje ndaj tij. Krahas gjithë atyre sa u thanë, për kurbanet e therur për hir të Allahut janë premtuar shumë e shumë shpërblime.

Ebu Saidi rrëfen se ka dëgjuar Profetin (a.s.) të thotë: "Ngrihu o Fatime e shih therjen e kurbanit, se për çdo pikë që pikon nga gjaku i tij shpërblehem me faljen e mëkateve që kemi bërë më parë. Ajo e pyeti: -O i dërguari i Allahut! A është kjo vetëm për Ehli Bejtin, apo për të gjithë myslimanët? Ai tha: -Për ne dhe për të gjithë myslimanët".

Një mysliman që e ther kurbanin me zemër të pastër dhe singeritet, ditën e gjykimit do të shpërblehet mirë tek Zoti. Pejgamberi ynë për këtë çështje shprehet: "Ditën e kurbanit nuk ka asnjë vepër të birit të Ademit më të dashur tek Allahu se sa therja e kurbanit. Ai kurban vjen ditën e gjykimit me brirët, lëkurën dhe thundrat e tij. Gjaku i kurbanit tek Allahu ka një vlerë të madhe. Kurban pranohet para se gjaku të bjerë në tokë. Paraqitini kurbanet tuaja tek Allahu me një zemër të pastër dhe të sinqertë." (Tirmidhi, Edahi 1; Ibn Maxhe, Edahi 3).

Kurbani i therur për hir të Allahut, në urën e siratit, që do të jetë një urë shumë e vështirë për t'u kaluar për në Ahiret, do të ndihmojë si kafshë mbartëse. Profeti ynë për këtë çështje ka urdhëruar e ka thënë: "Zgjidhni për kurban kafshën më të mirë e më të bukur, sepse ajo do t'ju mbartë ju mbi urën e siratit." (Deylemi, El-Firdevs bi Mesuri'l-Hitab, 1/85; Munavî, Feyzu'l-Kadir, 1/496. Shih: Bediüz-zaman, Sözlür, 17. Söz).

Kurbani mbart edhe plot vlera të tjera. Adhurimet, më shumë sesa për çdo vlerë e dobi jetësore, duhen kryer në radhë të parë për hir të Allahut. Në këtë kuptim, krahas çdo dobie individuale e shoqërore, kurban është një adhurim që kryhet për të arritur kënaqësinë e Allahut. Në Kuran thuhet: "Këtë mos e harroni, se as mishi i tyre (i kurbaneve), as gjaku i tyre assesi nuk mbërrin tek Allahu. Ajo çka mbërrin tek Ai është vetëm përkushtimi që ushqen në zemrat tuaja, është respekti për Allahun..." (Haxh, 22/37).

“Disident” me kohën

Njeriu është një qenie me natyrën dhe potencialin për të jetuar në shoqëri dhe për të krijuar relata me entitetet e saj. Që në lashtësi ai e ka shpalosur këtë aspekt të qenies së tij duke krijuar marrëdhënie të caktuara me njerëzit përreth tij në bazë të perceptimit dhe shijeve të tij në njërën anë, dhe faktorëve të vendosur në kohë dhe vende të caktuara që kanë karakterizuar jetën e tij në anën tjetër.

Jeta është një rrugëtim i përbashkët në kohë e vende dhe me karakteristika të caktuara për njeriun. Por, me përsosmërinë e krijimit të Tij, Zoti ia shpalos çdo shoqërie apo njeriu një jetë të krejt të veçantë me sfida dhe përgjegjësi të caktuara. Kështu në çdo situatë, mbeten e përjetshmja dhe e pandryshueshmja ajo që përcakton të përkohshmen. Rrjedhimisht janë parimet, të shoqëruara me motivet ato të cilat përcaktojnë veprimet e njeriut në këtë jetë.

Një aspekt i rëndësishëm i marrëdhënies së njeriut me entitetet e tjera është relata e tij me kohën në të cilën jeton. Nëse ka një relatë që karakterizon dinjitetin e jetës apo etikën e veprimeve tona, ajo është disidenca, konflikti dhe mospajtimi me kohën. Pra për të qenë në vendin dhe rolin e duhur, njeriu nuk duhet të lundrojë në drejtimin e rrymës pa pasur kontroll dhe pa qenë i vetëdijshëm për jetën e tij. Ai, me dëshirën për të përsosur shpirtin dhe arsyen e shëndoshë, do ti duhet të njohë dhe të përpiket të luajë rolin që i është përcaktuar që në para ekzistencë.

Nëse do të kthehemi pas në histori, profetët, dijetarët apo njerëz të lartë ishin “disidentë” me kohën në të cilën jetuan. Ndërkohë që shoqëritë jetonin në “paqe” me “fetë” e kohës ata me ndriçimin e besimit dhe arsyen e përsosur njerëzore duke vepruar me urtësi, arritën të tundnin tabutë dhe rendin e kohës, për ti hapur rrugën

paqes më thelbësore: asaj të njeriut me veten e tij.

Kur flasim për disidencë, është e rëndësishme të përcaktojmë natyrën dhe karakteristikat e saj. Ajo nuk është lehtësisht e dallueshme dhe që “bën zhurmë”, apo nuk mund të kufizohet në një aspekt të caktuar si, për shembull, ai politik. Ajo ka si lëndë shpirtin e njeriut, është në harmoni të plotë me rrugën e njeriut drejt përsosmërisë morale dhe karakterizohet nga një ndërgjegje që gjithmonë “qëndron zgjuar” e përpjekja për të bërë gjithmonë më të mirën.

Në shoqëri problemet dhe krizat në dimensione të ndryshme të caktuara të saj e kanë themelin te kriza e moralit e ky i fundit lidhet ngushtë me shpirtin e njeriut. Nëse ka një revoltë, dinamike dhe përpjekje, ajo është më parë shpirtërore. Kështu njeriu më parë duhet të jetë disident me problemet morale në shoqërinë e tij. Ndryshimi i vetes dhe përvetësimi i virtyteve është një themel i paluajtshëm dhe vendimtar për zgjidhjen e problemeve të mëtejshme.

Në aspektin shoqëror çdo kohë ka sfidat e saj dhe problemet që duhen zgjidhur. Kështu përtej dëshirës për të zgjidhur probleme të caktuara lind nevoja e kuptimit të problemeve dhe rolit që njeriu duhet të luajë në marrëdhënien e tij me brezat e tjerë por edhe me shoqërinë në të cilën jeton. Kjo i mundëson atij të mos e kufizojë përpjekjen dhe potencialin e tij vetëm mbi një objekt të caktuar, pra mbi atë gjë konkrete që do të kontribuojë, por mbi vlerat që do të promovojë dhe virtytet që do të përvetësojë nëpërmjet kontributeve. Kështu, i prirë nga urtësia dhe vizioni, duke kultivuar te vetja përlulesinë njeriu jep kontributin e tij që mund të mos bie në sy por është një pjesë e rëndësishme në ndërtimin e mozaikut madhështor të shoqërisë së tij dhe të gjithë njerëzimit.



XHAVIT ALIMEHMETI

(1929 - 1997)

Lindi në Tiranë në vitin 1929 në një familje tiranase me traditë fetare intelektuale, të gjithë të shkolluar në Turqi dhe në Arabi. Prindërit u interesuan që edhe Xhavitin ta arsimojnë me kulturë fetare. Pasi mbaron arsimin bazë, prindërit e dërgojnë në Medresenë e Tiranës, e cila në kohën kur u arsimua Xhavit, ishte institucion i barasvlershëm me shkollën e mesme. Në këtë shkollë Xhavit diplomohet me rezultate të shkëlqyera duke përvetësuar shumë mirë gjuhën e huaj Arabisht. Pas përfundimit të shkollës emërohet nëpunës në administratën e Komunitetit Mysliman dhe vaiz në xhaminë e Kokonozit. I përkushtuar në punë, me një sjellje shembullore dhe aftësi të rrallë, fiton zemrat e të gjithëve, që për gjithçka i referoheshin Xhavitit. Si vaiz, me ligjëratat e tij tërheqëse dhe përshkrimet e motivuara nga gjuha arabe tërhoqi zemrat e besimtarëve që e prisnin me kënaqësi Xhavitin kur zinte vend në podiumin e predikuesit. Ai u bë njeriu më i besueshëm, teolog i afirmuar, që fjala e tij zinte vend në zemrën e çdo besimtari. Por aktiviteti i tij në shërbim të fesë islame do të ndërpritesh në vitin 1967, vit në të cilin feja ndalohet me ligj nga pushteti komunist. Zemra e Xhavitit u trishtua nga shkatërrimet që iu bënë Institucionit të Komunitetit Mysliman. Pajisja e Xhavitit me një kulturë të lartë dhe aftësitë e tij intelektuale bënë që Instituti i Historisë ta ftojë për të punuar pranë tij. Kontributi në këtë institut u vlerësua shumë sidomos përkthimi i dokumenteve të arkivit të Institutit nga gjuha arabe. Jo vetëm kaq, por Instituti hapi dhe kursin për arabisht të drejtuar nga Z. Xhavit Alimehmeti. Ai

punoi në Institut deri në vitin 1989 kur i erdhi fundi regjimit komunist dhe u vendos sistemi demokratik. Në karakteristikën që i bëri Instituti i Historisë vlerësimit të punës së Z. Xhavit Alimehmeti, theksohet: "Duke karakterizuar portretin e këtij njeriu kaq human, punëtor dhe të sinqertë, me plot gojën kemi të bëjmë me njeriun që Zoti vetë e ka përgatitur për të dhënë gjithçka duhej në këtë jetë. Kjo gatishmëri i buronte nga shpirti, nga edukata që kishte marrë nga shkolla e Medresesë që ai kishte mbaruar, por edhe nga edukata familjare e tij që trashëgonte".

Menjëherë, në fillimet e demokracisë, shtëpia e tij bëhet qendra e takimeve për krijimin e institucionit të Komunitetit Mysliman, që përfundoi me ceremoninë e hapjes së xhamisë së sahatit (Et'hem Beu). Xhavit emërohet Vaiz përsëri në xhaminë e Kokonozit dhe mësues në kursin e përgatitjes së imamëve për nevojat e ngutshme për imam xhamish. Në portretin e xhamisë si vaiz mishëroi dashuria për fenë islame, bujaria për të dhënë gjithçka për të, duke fituar respektin e të gjithë besimtarëve. Ai mishëronte virtytet e larta morale sa që admirohej e respektohej nga të gjithë pa dallim. Ai ishte i kudondodhur dhe i kudogjendur për të kontribuar në çështjet e Islamit. Por i tillë mbeti dhe për Institutin e Historisë ku në karakteristikë theksohet: "Edhe pse mbushi moshën e pensionit nuk u largua nga Instituti, por e mbajtën në punë sepse e gjykonin të nevojshëm rolin dhe shembullin e tij model për të gjithë". Ndahet nga jeta më 23.01.1997. Sot emri i tij kujtohet me respekt të thellë për veprën e tij, për shpirtin e madh, vlerat që ai mbarte, virtytet dhe mirësitë që ai rrezatonte.



Xhamia e Berarëve
BERAT

Ngrihet në pjesën e poshtme të lagjes Mangalem. Ajo i ka shërbyer rufetit të beqarëve, të esnafëve të ndryshëm të qytetit që, si një bashkim i zejtarëve të pamartuar, kryente dhe shërbimin e ruajtjes së rregullit dhe të rojës së natës në Pazar. Sipas mbishkrimit, xhamia është pikturuar në vitin 1827-28 (1243 h).

Xhamia është ndërtuar në terren të pjerrët prandaj rezultoi me gjysmëkat. Ajo përbëhet prej dy vëllimesh nën të njëjtën çati, vëllimi kryesor në anën jugore, që ka një portik tri arkadash, tri galeri në pjesën e poshtme dhe hajati me arkada në anën veriore. Kati përbëhet nga salla e lutjeve dhe hajati apo portiku i hapur. Në sallën e lutjeve hyhet nëpër portik nga një rruginë në nivel më të ulët se dysheja e vetë portikut. Kjo ndodhet brenda një portali me gurë të gdhendur që ka mbi portë një dritare drejtkëndëshe, me përmasa 11-11,25 x 9,63-10,0 m. Salla, pas ndërhyrjeve restauruese, është mbuluar me tavan të riformuar. Salla ndahet në dy pjesë nëpërmjet një arkade treshe mbi dy shtylla druri. Në faqen jugore gjendet mihrabi si nike me prerje gjysmërrethi.

Salla e lutjeve është e shtruar me rrasa guri. Ajo ndriçohet me dritare të vendosura në dy radhë, në të katër faqet anësore. Të gjitha dritaret e radhës së poshtme janë drejtkëndëshe dhe të mbuluara me arkitrarë druri, ndërsa dritaret e sipërme, janë të mbuluara me hark gjysmërrethi në anën e jashtme dhe me arkitra të rrafshët në brendësi. Dy çifte dritaresh ka në krahun jugor në të dy anët e mihrabit, nga tre çifte në faqet lindore dhe perëndimore dhe katër dritare ajo veriore në të dy anët e portës së hyrjes për në sallën e lutjeve.

Portiku në anën veriore shtrihet më tepër se sa muri verior i sallës së lutjeve, dukuri që e kemi parë dhe në xhaminë Mbret po në Berat, ku krijohet një mjedis shtesë për faljen e besimtarëve. Po për këtë arsye një mihrab i dytë është krijuar në faqen e murit verior të sallës së lutjeve. Kështu, hajati qarkohet me arkada të plota nga anët jugore, lindore dhe perëndimore, dhe me harqe të veçantë në anën jugore, në pjesët ku lidhet vëllimi i sallës së lutjeve me arkadat. Në anën veriore arkada përbëhet prej 6 harqesh që mbështeten në dy pilastra, të cilat kanë formën e shkronjës "L" dhe pesë kolona. Në këtë anë ndodhet dhe hyrja për në portik. Arkada lindore përbëhet nga dy harqe që mbështeten në dy pilastra dhe një kolonë, ndërsa arkada perëndimore ka tre harqe, duke përfshirë hajatin dhe një dritare të sallës së lutjeve e duke arritur deri te bazamenti i minares.

Kolonat, të përbëra prej rrotullash guri, mbështeten mbi bazamente guri në formën e trungut të piramidës. Kapitelet mbi to, janë në forma pak më të zhvilluara. Harku, që mbështetet drejt e në kolonat, është në formë gjysmërrethi, i ndërtuar me gurë të skuadruar, të vendosur sipas rrezeve, pak më brenda faqes së murit mbi të. Ai qarkohet nga një hark tjetër më i ngushtë me gurë të vendosur sipas perimetrit.

Minarja ngrihet mbi bazamentin prizmatik dhe trupi i saj i ulët është shumëfaqësh e me kanelyra. Mbi të kemi kazanin e nxjerrë konsol ndaj trupit, nëpërmjet tullash dhëmbështare që dalin ndaj njëra-tjetrës.

Pjesa nën kat e xhamisë në anën jugore është në

formën e një portiku tre pjesësh, ndërsa në anët e tjera, e mbyllur dhe sipas terrenit. Faqja jugore dhe pjesa mbi harqet e vegjël anësore të portikut është ndërtuar me gurë të gdhendur e me fuga të holla ndërmjet tyre. Muret e tjerë janë ndërtuar me gurë të papunuar, të nxjerrë në formacione shtresore. Pjesa me gurë të gdhendur ndahet nga pjesa mbi të, që i takon sallës së lutjeve, nëpërmjet një kornize guri. Të gjitha muret e tjerë (me përjashtim të portikut) janë të suvatuara dhe pikturuar me motive blloqesh kuadratik të rregullt. Kiel me të drejtë mendon se kjo mënyrë zbukurimi që imiton muraturën, e njëjtë me atë të xhamisë së sultan Bajazitit II, ndihmon për të gjetur dhe datën e rindërtimit të saj. Me interes është zbukurimi i pjesës së sipërme, nën strehë, i mureve të sallës së lutjeve me pikturë murale. Ky brez është i ndarë në panele të veçantë të zbukuruara me motive bimore dhe peizazhe me pamje qyteti.

Piktura murale është aplikuar dhe në brendësi të sallës së lutjeve, e organizuar në dy breza horizontalë në pjesën e sipërme të mureve, piktura, që paraqesin pamje të sajura qytetesh, ndërtesa e xhami si dhe zbukurime me motive bimore, me panele të veçantë e rrallë ndërtesa. Me përsëritjen e motiveve të përafërta, piktura luan një rol jo të vogël në njësimin e brendësisë dhe perceptimin më të lehtë të saj.

Xhamia e Beqarëve është një ndërtim me vlerat arkitekturore dhe me një vendosje interesante në ansamblin e lagjes dhe në terrenin e pjerrët. Në pamjet e jashtme ajo shquhet për vëllimin masiv dhe minaren e ulët, arkadën e përpamë që, së bashku me pjesën mbi të, me gurë të gdhendur, është në rolin e një bazamenti për vetë xhaminë. Interesante është dhe vendosja e brezit të pikturuar nën strehët, që kurorëzon vëllimin e ndërtesës, duke vlerësuar më tepër dekorin. E parë në tërësinë e zgjidhjes arkitektonike ajo afrohet së tepërmi me arkitekturën popullore, duke u bërë pjesë e ansamblit. Gjithashtu me vlerë është dhe portiku me arkadat e tij, që fut në lojë një notë interesante në tërësinë e rrugicave dhe shtëpive pranë.

Ndërtimi i xhamisë së Beqarëve duhet të jetë bërë pak përpara vitit 1827, kur është pikturuar.

Për të njohur më mirë ndërtesën dhe historinë e saj, me interes janë të dhënat që na jep Vexhi Buharaja dhe që konfirmohen edhe nga Kiel, të cilat nxirren nga interpretimi i mbishkrimit të xhamisë. Shkruesi i vargjeve është poeti Arif Hikmet, i cili ishte edhe kryegjyqtari ushtarak (kadiasker) i Rumelisë. Nga mbishkrimi mësojmë se xhamia nuk është ndërtuar nga esnafi i beqarëve, por duket se u shërbente atyre si vend pushimi e faljesh. Xhamia është ndërtuar nga Sulejman Pasha, djali i Ibrahim Pashë Vlorës, që u bë guvernator në vitin 1824-25 (1240 h). Është me interes të shënojmë se në Berat ishte dhe xhamia e Ibrahim Pashë Vlorës, e cila u rindërtua pas tërmetit të vitit 1852, por Buharaja na thotë se, në dëshmi të shkruara të shekullit XVIII-të, xhamia përmendet me emrin e Beqarëve, domethënë nga Sulejman Pasha kemi pikturimin dhe ndonjë rindërtim të saj.¹

1. Marrë me shkurtime nga libri "Xhamitë e Shqipërisë, historia, arkitektura, shek. XV-XIX.



MË FOL PËR *Krijuesin*

Edukata fetare jepet e shoqëruar me shumë butësi e dashuri që në moshë të vogël. Të folurit rreth Zotit dhe rreth bukurive të besimit është shumë e rëndësishme përsa i përket zhvillimit shpirtëror e emocional të fëmijës. Duhet treguar kujdes me mënyrën sesi ja transmetojmë këto vlera, sesa në lidhje me çfarë i themi.

Pra, cilën rrugë duhet të ndjekim për t'u folur fëmijëve për Zotin?

Pikë së pari duhet të jemi të qartë në perceptimin që fëmijët nuk i konceptojnë gjërat si ne. Ne zotërojmë koncepte të rrënjosura në vetëdije me ose pa dëshirën

tone. Psikologjia e një fëmije është shumë e ndryshme nga ajo e një të rrituri. Logjika e një fëmije duhet të na shërbejë si një pikë mbështetëse kur i flasim për Krijuesin. Fëmijët e moshës 0-6 vjeç janë në periudhën objektive dhe akoma nuk zotërojnë aftësinë e të menduarit subjektiv. Sigurisht që konceptet si: Krijues, fe, besim, parajsë, mirësi, mëkat, e drejtë e gabuar janë subjektive. Nëse do përpiqemi t'ja shpjegojmë në mënyrë subjektive, atëherë do ta konfuzojmë më tepër fëmijën.

Është shumë e vështirë të shpjegosh subjektiven në mënyrë objektive, nëse na duhet të japim shembuj:

Nga veprimi apo fjalët tona duhet të notojmë drejt

subjektives. Si mund ta bëjmë? Mund të fillohet duke i thjeshtuar dukuritë me gjërat e bëra nga Krijuesi si p.sh.: Allahu është Krijuesi, ti je dhuratë e Tij, të krijoj nga asgjëja. Edhe lulet i çel Zoti, frutat që hamë vijnë nga Ai. Sigurisht që mendimi subjektiv tek fëmijët fillon pas moshës 3 vjeçare. Të pyeturit rreth Zotit, vdekjes apo gjërave tjera subjektive fillon pas moshës 3 vjeçare. Nuk shihet e përshtatshme vendosja dhe transmetimi i njohurive subjektive bazuar tek rregulli dhe disiplina gjatë moshës 3-6 vjeç sepse është pikërisht kjo periudhë apo moshë ku shfaqet më tepër këmbëngulja dhe kokëfortësia e fëmijës. Gjatë kësaj periudhë fëmija përpaket të bëjë të kundërtën e asaj që i thuhet. Pra është moshë e individualizimit, pavarësisë të cilën mund ta quajmë ndryshe një miniadoleshencë.

Një moshë ku kemi dëshirën e pafund për të zbuluar e mësuar gjëra të reja në botën përreth dhe në të njëjtën kohë një miniadoleshencë ku fëmija nuk pranon gjërat e transmetuara me detyrim. Këtu duhet të përpqemi t'i transmetojmë fëmijës vlerat e dëshiruara pa përdorur një mënyrë strikte. P.sh.: nëse duam t'i flasim për Allahun, mjafton t'i lexojmë historitë, tregimet rreth jetës së profetëve, t'i flasim rreth jetës së Hz. Jusufit, dashurisë së Hz. Jakubit për bijtë e tij, këshillave të Llukmanit duke nxjerrë mesazhet e dëshiruara. Duke u folur rreth profetëve, cilësive të tyre do të mund t'u japim një shembull konkret të mirësisë, solidaritetit, sacrificës dhe dashurisë së sinqertë, koncepte të cilat konsiderohen subjektive për një fëmijë të moshës 3-6 vjeç.

Në këtë fazë është shumë e rëndësishme dhe leximi, formimi i prindërve, mënyra se si ato lexojnë historitë, dëshira për të zbuluar gjëra tjera. Sa më aktivë të jenë prindërit aq më shumë rezultate pozitive do merren në formimin emocional të fëmijës.

Fëmijët mund të bëjnë pyetje të ndryshme ose mund të qëndrojnë indiferentë. Si duhet të sillemi në këtë rast ?

Pikë së pari duhet ta dimë se para se t'i përgjigjemi pyetjeve dhe kureshtjes së fëmijëve tanë, duhet të jemi të mirëinformuar dhe të jemi gati për një prindërim sa më të suksesshëm. Dhe ç'është më e rëndësishme duhet ta duam, ta praktikojmë vetë diçka para se t'ia mësojmë fëmijës sepse fëmijët mësojnë duke imituar. E njëjta gjë na ndodh edhe ne, nëse personi përballë nesh është i mërzhitur kjo ndienjë apo atmosferë na kalon edhe neve, pra ndikohemi dhe ne. Nëse personi përballë është aktiv dhe plot jetë edhe ne fluturojmë nga gëzimi. Aftësitë e perceptimit emocional tek fëmijët janë edhe më të zhvilluara e të ndjeshme se tonat. Ato mësojnë bazuar në një model sepse nuk e kanë akoma të zhvilluar aftësinë e të logjikuarit drejt. Prandaj është shumë e rëndësishme që ne të pasqyrojmë një model të pranueshëm para fëmijës dhe t'i ndjejmë në shpirt konceptet e transmetuara. Kur fëmija merr mesazhin e forcës dhe detyrimit mund të reagojë ashpër duke mbyllur dyert e komunikimit.

Nëse duam të jemi të suksesshëm në transmetimin e

njohurive të caktuara në radhë të parë duhet të kemi një komunikim të shëndetshëm me fëmijën. Ky komunikim arrihet brenda një kohe të caktuar, pasi ju të keni investuar nga koha juaj dhe t'u keni dhuruar fëmijëve dashuri e siguri. Ndonjëherë të duhet të bëhesh fëmijë, të luash me të, ndonjëherë duhet të vendosësh kufijtë dhe ca rregulla të vogla. Këto janë të rëndësishme për një marrëdhënie të shëndoshë prind-fëmijë, sepse modeli i marrëdhënies së vendosur me prindërit i jep formë në një mënyrë edhe marrëdhënies tonë me Krijuesin. Nëse prindi është autoritar dhe i rreptë, fëmija mund ta konceptojë dhe Zotin të tillë, sepse marrëdhënia me Krijuesin konsiderohet si një vazhdimësi e marrëdhënies së parë me nënën dhe pastaj me babain.

Lutja, një pikë shumë e rëndësishme në edukimin fetar

Po, një fenomen i cili shndërron subjektiven në objektive, prek drejtpërdrejt shpirtin e njeriut. Në moshën 5 ose 6 vjeçare fëmijët janë më egocentrikë dhe kërkojnë t'u plotësohen kërkesat apo dëshirat e tyre. Prindërit duhet të përpqen të gjejnë mënyrën e duhur për ta mësuar fëmijën të kërkojë diçka nga Krijuesi. Kjo do të ndikojë pozitivisht në zhvillimin e fëmijës dhe do të forcojë lidhjen me Krijuesin. Të përpqemi të japim shembuj konkretë nga jeta e përditshme duke zgjuar dhe kureshtjen e fëmijës. 'Ja shiko, sot lindi dielli, Zoti e bën diellin të lindë, si do ishte bota ku jetojmë po të mos lindte dielli? Si do të bëhej ditë, si do të ngriheshim në mëngjes?'

Le të mendohejmë tu mësojmë fëmijëve tanë mirësinë, sacrificën, dashurinë për të tjerët me sjelljet tona dhe jo me fjalët si bën apo nuk bën kështu. Në moshën 3-6 vjeç ato fillojnë të zhvillohen, të bëjnë më shumë pyetje, të jenë kuriozë në çdo gjë që përballen. Të mësuarit e vlerave të caktuara vjen para edukimit fetar. Mësimi i vlerave arrihet me anë të prindërve, mësuesve, shfaqjeve në drama, përrallave, historive edukuese etj. Besoj që suksesi është i pashmangshëm nëse fëmija arrin të shohë një model perfekt fetar tek nëna dhe babai i tij dhe edukohet bazuar në vlerat universale.

Si përfundim

Është shumë e rëndësishme të hysh në botën e fëmijës. Në fillim duhet krijuar lidhja, siguria, dashuria e më pas të japësh diçka. Nëse arrini të krijoni lidhje të shëndoshë me fëmijën tuaj, atëherë mund t'i transmetoni atij çfarë të doni. Në rastet e vartësisë ndaj lëndëve narkotike, lidhjeve të gabuara të dashurisë apo martesave të gabuara, vihet re një tentativë largimi nga ambjenti familjar dhe kërkimi i rrugëve tjera të plotësimit të sigurisë së munguar në familje. Drama të tilla ka raste që ndodhin edhe në familje të mbushura me vlera dhe kjo është shumë pikëlluese. Familjet mund të kenë qëllimin e mirë për të bërë diçka por rruga që ndjekin mund të jetë e gabuar, që që çon në dështime të tilla. E rëndësishme është të gjejmë rrugën e duhur për të bërë gjënë e duhur.



Hambari

që s'u zbraz kurrë...

Dy vëllezër, njëri i martuar e tjetri beqar, jetonin dhe punonin në çiflikun që i kishte lënë trashëgim i ati. Në mbrëmje, ata e ndanin në mënyrë të barabartë prodhimin dhe fitimet që kishin nxjerrë gjatë ditës.

Një ditë, vëllai beqar mendon me vete: "S'ka kuptim që ne i ndajmë prodhimet tona në mënyrë të barabartë. Unë jam beqar dhe nuk kam askënd tjetër për t'u kujdesur përveç vetes sime, ndërsa im vëlla ka fëmijë e familje dhe ka më shumë nevojë se unë për të mira materiale". Kështu ai ngrihej çdo natë, në fshehtësi të plotë merrte një thes nga prodhimet e veta dhe e dërgonte në hambarin e vëllait.

Nga ana tjetër vëllai i martuar thotë me vete: "Ç'kuptim ka që i ndajmë prodhimet në mënyrë të barabartë? Fundja unë jam i martuar dhe kam fëmijë, në një farë mënyrë e kam rregulluar jetën time dhe në të ardhmen mund të më mbajnë fëmijët, ndërsa im vëlla është beqar e s'ka kush të kujdeset për të. Ai s'e ka filluar ende jetën e tij familjare, prandaj ka më shumë nevojë se unë për të mira materiale". Edhe ai si vëllai i tij, ngrihej natën fshehurazi dhe merrte nga një thes prej prodhimeve të tij dhe e dërgonte te hambari i vëllait beqar.

Kaloi kohë dhe vëllezërit nuk po kuptonin dot pse nuk po boshatiseshin hambarët e tyre, po ishin gjithnjë plot. Një natë, teksa ishin duke dërguar fshehurazi thasët e prodhimeve, nëpër hambarët e njeri-tetrit, vëllezërit përballen bashkë dhe për një moment mbeten si të ngrirë duke u parë në sy. Pastaj, pasi kuptuan gjithçka, i lëshuan thasët në tokë dhe u përqaftuan fort me lot në sy.





BOTIMET KMSH

*BOTIM
I RI*



AUTORITETI I ISLAMIT, SIMBOLI I DASHURISË, MREKULLIA E KOHËS

Dorian Demetja

Në këtë libër është përfshirë kryesisht jeta dhe vepra e tre njerëzve të mëdhenj, të cilët kanë jetuar në shekujt XI – Ebu Hamid El-Gazali, XIII - Mevlana Xhelaledin Rumi dhe XX – Bediuzzaman Said Nursi. Këta dijetarë të fesë, punuan shumë për të dhënë interpretimet dhe mesazhet e duhura të Islamit në kohën kur kanë jetuar.